



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim Publik”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. PhD. Noela Mahmutaj
2. Prof.As.Dr. Anisa Subashi

Shkurt 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Bachelor në “Administrim Publik” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu, Durrës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrimit Publik
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Administrim Publik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 685, datë 28.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 2085/1 Prot., datë 27.06.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 97, datë 05.06.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohe të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022-2023: 19 PAE dhe 5 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti 2020-2021: 40 studentë Viti 2021-2022: 41 studentë Viti 2022-2023: 39 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “Administrim Publik” filloi aktivitetin në vitin 2010 kur u hap për herë të parë me VKM Nr. 685, datë 28.05.2010. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Administrimit Publik, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe, në 3 vite akademike, me 180 ECTS. Programi i studimit Bachelor në “Administrim Publik” synon të ofrojë një realizim të koncepteve në fushën e administrimit publik dhe të analizojë rolin e sektorit publik në zhvillimin e vendit dhe lidhjet e tij me fusha të tjera të realitetit shoqëror. Misioni i këtij programi është të përgatisë studentë të cilët të aftësohen në hartimin e politikave publike brenda strukturave që lidhen direkt dhe indirekt me administratën publike qendrore dhe lokale. Qëllimi i këtij programi është të aftësojë studentin në njohjen e fenomeneve publike, si dhe rolin e administratorit publik.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e ‘Kartës së Bolonjës’ dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së misionit të IAL-së të përcaktuar në Statutin e tij. Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në Administrim Publik, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të IAL-së. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në fushën e Administrimit Publik, Menaxhimit Publik, Menaxhimit të Shërbimeve Publike etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë, mund të punësohet si specialist në organizatat e sektorit publik, si dhe në kompanitë private në fushat e lartpërmendura.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të angazhuar nga ASCAL dhe BA. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Prof. Asoc. Dr. Anisa Subashi dhe PhD. Noela Mahmutaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Ersi Dako, Koordinatore Teknike e ASCAL.

Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetëse të përcjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që realizoi në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacione të marra gjatë takimeve dhe intervistave që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, GVB, sekretarinë, zyrën e karrierës, punonjësen e bibliotekës, përfaqësues nga Drejtoritë e ndryshme si e projekteve dhe e Burimeve njerëzore etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qenë kriteret ligjore në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit të ciklit të parë të studimeve bachelor në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri.

Draft-Raporti u përcoll në Institucion përmes AMS më datë 12.01.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 19/1 Prot., datë 12.01.2024. IAL përcolli përgjigjen përmes AMS më datë 09.02.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 131/1 Prot., datë 07.02.2024.

GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes komentet e IAL-së, analizon si më poshtë vijon:

- **Standardi II.1, kriteri 4 dhe konkluzionet; Standardi II.4, kriteri 3; Standardi IV.1, kriteri 8**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport:

Standardi II.1, kriteri 4: GVJ rekomandon futjen e Praktikës Profesionale në planin mësimor.

Standardi II.1, konkluzionet: Programi i studimit nuk ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale. GVJ rekomandon futjen e Praktikës Profesionale në planin mësimor.

Standardi II.4, kriteri 3: GJV rekomandon futjen e praktikës profesionale në planin mësimor për këtë program studimi, si një kriter i rëndësishëm me qëllim që të përmbushen standardet e cilësisë dhe në nivel evropian.

Standardi IV.1, kriteri 8: GVJ rekomandon përfshirjen e praktikës mësimore në kurrikulën e programit, në mënyrë që studentët të kryejnë praktikën mësimore pranë institucioneve që UAMD ka marrëveshje dhe përshtatet me profilin e studimit.

Komenti i IAL: Bachelor në Administrim Publik është hapur dhe riorganizuar duke e miratuar planin mësimor në të gjitha hallkat si dhe në Senatën Akademik si dhe në MASR. Plani mësimor si dhe paketa e kërkuar e dokumentacionit respektiv është hartuar në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Praktika mësimore është konceptuar e shpërndarë në disiplina të ndryshme si dhe në organizimin e aktiviteteve me përfitim praktik për studentët e bachelor në Administrim Publik.

Përgjigje GVJ: Praktika mësimore përbën një element të rëndësishëm në kurrikulë, e cila parashikon të mundësojë përdorimin e njohurive teorike të fituara në kurset në një kontekst praktik dhe profesional. Prandaj ende rekomandohet nga GVJ për futjen e praktikës profesionale si një lëndë plotësuese. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

➤ **Standardi III.3, kriteri 5**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport: Infrastruktura logjistike që mund të sigurojë plotësisht këtë proces mungon dhe kjo detyrë kërkon të garantohet në Universitet infrastruktura e nevojshme për kontrollin e plagjiaturës.

Komenti i IAL: Departamenti Administrim Publik prej vitesh përdor sistemin Cleanscore të ofruara nga AADF në bashkëpunim me UAMD. Ndërkohë që më datë 09.10.2023 Departamenti Administrim Publik ka marrë në administrim programin ITHENTICATE për kontrollin e plagjiarizmit blerë në kuadër të infrastrukturës së Projektit të ndërkombëtarizimit Diplomë e Dyfishitë në Master i Shkencave në Administrim Publik (bashkëngjitur screenshot të sistemit).

Përgjigje GVJ: GVJ ka zhvilluar vizitën në ambientet e UAMD më datë 7 qershor 2023, ku më pas është bërë shkrimi i raportit bazuar nga vizita e kryer. Ndërkohë, Cleanscore është një program që merret korrigjimin e automatizuar të provimeve dhe programi i ri iTHENTICATE për kontrollin e plagjiarizmit vjen disa muaj pas vizitës. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

➤ **Standardi IV.3, kriteri 1, kriteri 2, kriteri 4, kriteri 8 dhe konkluzionet**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport:

Standardi IV.3, kriteri 1: Referuar Aneksve mbi fondin e bibliotekës, konstatohet ajo disponon një fond të lartë librash dhe kopjesh, por nuk evidentohet përshtatja e këtyre tekseve me programin specifik në Administrim Publik. Gjithashtu anëtarësimi në JSTOR dhe U-Library garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe kjo jo në gjuhën shqipe, e cila është gjuhë e detyruar për programin Bachelor. Evidentohet se literatura është kryesisht në anglisht gjë e cila konsiderohet e papërshtatshme për studentët e programit Bachelor. Ka përpjekje për të garantuar literaturë bashkëkohore të dedikuar programit por miratimi i blerjes nuk është realizuar akoma.

Standardi IV.3, kriteri 2: Ka përpjekje për të garantuar literaturë bashkëkohore të dedikuar programit por miratimi i blerjes nuk është realizuar akoma.

Standardi IV.3, kriteri 4: Biblioteka e UAMD është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmojë studentet në përgjithësi por nuk evidentohet përshtatja e këtyre teksteve me programin specifik në Administrim Publik.

Standardi IV.3, kriteri 8: Nga takimi me stafin u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë plotësuese por për këtë vit akoma nuk ishte miratuar lista e librave të kërkuar nga departamenti. Nuk gjenden raporte analitike mbi efektshmërinë e investimeve në pasurimin e fondit fizik dhe atij online.

Standardi IV.3, konkluzionet: GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e cila duhet marrë vëmendje, të analizohet dhe të ndërtohen plane konkrete veçanërisht për fondin fizik të librit shqip dhe dorëzimin e leksioneve të pedagogëve pasi kështu mund të mundësohet pasurimi i fondeve dhe përditësimi i literaturës.

Komenti i IAL: Në çdo vit akademik Departamenti Administrim Publik së bashku me syllabuset kërkon depozitimin e leksioneve si dhe librave të literaturës bazë dhe alternative të lëndëve. Aktualisht Departamenti Administrim Publik ka blerë në kuadër të projektit të ndërkombëtarizimit listën e mëposhtme të librave të cilët janë blerje ekskluzive për profilin Administrim Publik (bashkëngjitur lista e literaturës në kuadër të projektit të ndërkombëtarizimit).

Përgjigje GVJ: Lidhur me pikat e pasqyruara nga GVJ në raport, evidentohet se GVJ i është referuar dokumentacionit të përcjellë nga IAL dhe vizitës së realizuar në Institucion, ndërkohë që dokumentacioni i përcjellë nga IAL me këto komente, në kuadër të projektit të ndërkombëtarizimit, i përket një periudhe pas realizimit të vizitës në Institucion. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

➤ **Standardi V.5, kriteri 3 dhe konkluzionet; Standardi V.6, kriteri 3**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport:

Standardi V.5, kriteri 3: Nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to.

Standardi V.5, konkluzione: UAMD përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe zhvillimit të institucionit. Por në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e studentëve dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to.

Standardi V.6, kriteri 3: Gjithashtu në këtë kuadër ky sektor, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, ëorkshop-e, harton dhe raporton periodikisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat statistikore. Por studentët nuk e njihnin mirë rolin e plotë të zyrës.

Komenti i IAL: Institucioni, Zyra/njësia për Këshillimin e Karrierës si dhe Departamenti Administrim Publik organizon aktivitete të ndryshme që kanë si qëllim kompletimin e procesit mësimor, praktikën profesionale si dhe orientimin në tregun e punës dhe promovimin e diplomës së tyre. Mungesa në njohjen e zyrës së karrierës vjen edhe nga fakti se marrëdhënia fizike ndërmjet disa strukturave në nivel institucional dhe studentëve u pengua nga periudha e fatkeqësive si tërmet dhe pandemia COVID 19.

Përgjigje GVJ: Në arsyetimet e pasqyruara në raport, GVJ i është referuar dokumentacionit të përcjellë nga IAL dhe vizitës së realizuar në IAL, veçanërisht takimit të realizuar me studentët e programit të studimit, në të cilin u konstatua se nuk e njihnin rolin e plotë të zyrës. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

➤ **Standardi V.6, kriteri 4**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport: GVJ konfirmon që zyra nuk ka mundur të zhvillojë çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar, pasi stafi në dispozicion nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk mund të realizohej një gjurmim i tillë për të gjithë programet.

Komenti i IAL: Zyra e karrierës asistohet në mënyrë aktive nga strukturat akademike dhe ndihmës akademike gjë e cila e lehtëson punën e kësaj zyre, mungesat e vrojtimit si në çdo institucion tjetër për shkak të periudhës së fatkeqësive si tërmet dhe pandemia COVID 19.

Përgjigje GVJ: Në arsyetimet e pasqyruara në raport, GVJ i është referuar dokumentacionit të përcjellë nga IAL dhe vizitës së realizuar në IAL, nga të cilat është evidentuar dhe përfshirë në raport një konstatim i tillë. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

➤ **Standardi V.6, konkluzionet**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport: UAMD ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron promovimin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në të gjithë universitetin dhe zgjerim të stafit të zyrës.

Komenti i IAL: Ky rekomandim është për tu vlerësuar në nivel institucional.

Përgjigje GVJ: Në komentin e tij, IAL nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim, por është shprehur se rekomandimi do të vlerësohet në nivel institucional. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

➤ **Standardi VI.3, konkluzionet**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport: GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve në institucion, konstaton se UAMD monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ sugjeron që e njëjta procedurë (intervista gjysëm të sturkturuara, fokus grupe apo dhe sondazhe), të ndiqet në vijueshmëri nga departamenti edhe për ata ish-studentë, bashkëpunëtorë, staf administrativ apo studentëve të këtij programi, si një mënyrë shumë efektive e vlerësimit të përgatitjes akademike që aktualisht ofrohet nga programi.

Komenti i IAL: Kjo iniciativë ka filluar tashmë prej vitesh nga Departamenti Administrim Publik, është reflektuar edhe në dokumentacionin respektiv. Sigurisht gjatë periudhave të fatkeqësive si tërmet dhe pandemia COVID 19 ka patur shkëputje.

Përgjigje GVJ: Në arsyetimet e pasqyruara në raport, GVJ i është referuar dokumentacionit të përcjellë nga IAL dhe vizitës së realizuar në IAL, nga të cilat është evidentuar dhe përfshirë në raport një konstatim i tillë. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

➤ **Standardi VI.5, kriteri 4 dhe konkluzionet**

Konstatimi i GVJ në Draft-Raport:

Standardi VI.5, kriteri 4: GVJ mendon që krahas këtyre raporteve, NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar lidhur me programin e studimit.

Standardi VI.5, konkluzionet: GVJ konstaton se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. Konkretisht, kjo është realizuar nëpërmjet publikimit të Rregullores së UAMD, Rregullores së Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. GVJ mendon që krahas këtyre raporteve, NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar lidhur me programin e studimit.

Komenti i IAL: NJSBC e FSHPJ është gjithnjë pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit vjetor. Ky grup harton periodikisht raportin vjetor të aktivitetit të FSHPJ ku integrohet edhe aktiviteti i vetë NJSBC të FSHPJ.

Përgjigje GVJ: GVJ, sikurse reflektuar edhe në raport, vlerëson se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. Por, GVJ, vijon të mendojë që krahas raportimit që realizohet dhe përfshihet në rang institucioni në raportin vjetor të tij, NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar lidhur me programin e studimit. Për sa më lart, raporti për këtë pikë nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Administrim Publik”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është institucion i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimi në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore. Në dokumentin “Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 UAMD” miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 60, date 26.10.2020, theksohet se UAMD ka si mision të kryejë mandatin e tij arsimor dhe shkencor në mënyrë të kënaqshme dhe në hap me kohën, të promovojë Arsimin e Lartë duke shkëmbyer njohuri dhe duke gjeneruar ide të reja dhe moderne, të promovojë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe Universitetit, të garantojë mundësi të barabarta për stafin akademik në përfitimet e financimeve për kërkim shkencor. Ndërkohë në dokumentin “Plani Strategjik i Departamentit Administrim Publik për periudhën 2020-2025” theksohen objektivat strategjike të programit si indikatorët e performancës dhe promovimi i tij, lidhja me tregun e punës, si dhe promovimi i hapsirave dhe rëndsisë së këtij profesioni në sektorin publik dhe atë privat. Programi i studimit i ciklit të parë “Bachelor në Administrim Publik” i referohet nivelit 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. <i>Aneks 5. Ligj_80-2015_22.07.2015;</i> <i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës;</i> <i>Aneks 10. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025;</i> <i>Aneks 17. Planifikimi Strategjik DAP 2020-2025.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në Administrim Publik është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimet, misionin si dhe fushën e veprimtarisë së UAMD-së, FSHPJ-së, DAP. Ky kriter shprehet dokumentet si: Statuti i Ri i Universitetit “Aleksandër Moisiu” (2018, i ndryshuar me me vendim të Senatit Akademik nr. 60, date 26.10.2020), Neni 3 “Misioni”, ku IAL deklaroi se “UAMD ka për mision të krijojë, të zhvillojë e të përcjellë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndenjen e përgjegjësisë dhe të angazhimit ndaj njeriut, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme



	<p>që kanë lidhje me individin dhe komunitetin; të përgatisë profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane, si dhe të nxisë dhe ofrojë arsimin universitar të integruar me praktikën profesionale të drejtëpërdrejtë në sipërmarrje”. Strategjia e Zhvillimit 2020-2025 e FSHPJ thekson misionin kryesor të saj në përputhje të plotë me misionin e UAMD.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës;</i> <i>Aneks 16. FSHPJ Strategjia 2020-2025, fq. 2.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit të Bachelor në Administrim Publik është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p> <p>Në dokumentin “Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHPJ-së 2020-2025” theksohet se FSHPJ është i njohur për cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor duke u renditur ndër institucionet me të rëndësishme, i cili kontribon për një të ardhme të shkëlqyer të studentëve, komunitetit të Durrësit dhe të vendit, si dhe për rritjen ekonomike dhe mirëqënien e shoqërisë. Vizioni i FSHPJ është të fuqizojë sa më shumë studentët e vetë që ata të bëhen zgjidhës të problemeve, specialistë me kompetenca e njohuri që adresojnë sfidat e kohës.</p> <p>Në dokumentin “Planifikimi Strategjik DAP 2020-2025” citohet: “misioni i Departamentit Administrim Publik është të vë në zbatim standardet më të larta të kodit të cilsisë duke i aktualizuar ato me jetën e ditëpërditëshme si njësi bazë. Gjithashtu rritja akademike dhe shkencore e personelit akademik duhet të jetë në përputhje me profilizimin e departamentit në kushtet e kërkesave të sferës publike brenda dhe jashtë Shqipërisë.” Në dokumentin “Rregullore e Programit të studimit të ciklit të parë, profili Administrim Publik” Neni 2 tregon se “Kushtetuta, Kodi i Punës, Kodi i Procedurave Administrative, Ligji për Arsimin e Lartë, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Statuti dhe Rregullorja e UAMD-së janë baza kryesore juridike e kësaj Rregulloreje”.</p> <p><i>Aneks 16 FSHPJ Strategjia 2020-2025.</i> <i>Aneks 17. Planifikimi Strategjik DAP 2020-2025.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit Bachelor Administrim Publik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, ku ofrohet programi i studimit është pjesë përbërëse e strukturës akademike të UAMD-së, i cili përbëhet nga tri njësi bazë: 1. Departamenti i Drejtësisë; 2. Departamenti i Shkencave Politike; 3. Departamenti i Administrimit Publik.</p> <p>Në dokumentet e ofruara rezultoi se Departamenti i Administrimit Publik, për vitin akademik 2022-2023, ka gjithsej 31 pedagogë, nga të cilët 14 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 6 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 janë</p>

	<p>Asistent Lektorë me Msc; dhe 17 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 1 ka gradën Dr./PhD. dhe 12 janë Asistent Lektorë me Msc dhe në proces Dr.</p> <p>Pë sa më sipër DAP demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit.</p> <p><i>Aneks shtesë gjatë vizitës, tabela 2.</i></p>								
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në dokumentin “Plani Strategjik i Zhvillimit të FSHPJ-së 2020-2025” theksohet se vizioni i FSHPJ është të fuqizojë sa më shumë studentët e vetë që ata të bëhen zgjidhës të problemeve, specialistë me kompetenca e njohuri që adresojnë sfidat e kohës.</p> <p>Referuar dokumenteve DAP ofron 9 programe studimi, nga të cilat 3 programe studimi Bachelor (në të cilat përfshihet edhe programi Bachelor në Administrim Publik), 4 programe studimi master profesional dhe 2 program studimi Master i Shkencave. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të DAP, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.</p> <p><i>Aneks 16. FSHPJ STRATEGJIA 2020-2025.</i></p> <p><i>Aneks 59. DAP UAMD FSHPJ tabela e vendimeve të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Aneks 36. Kodifikimi Programeve 2022.</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ nga vlerësimi i dokumentave dhe vizita në institucion shprehet se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ofron programe studimi në përputhje të plotë me vlerat më të larta dhe interesat kombëtare. Ai demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Administrim Publik është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>FSHPJ në lidhje me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit e demonstroi në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UAMD-së.</p> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njërive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit. Në rregulloren mësimore të programit të studimit janë të përcaktuara qartë roli dhe detyrat e njësisë bazë, përgjegjësit e grup-lëndëve/koordinatorit të programit, të lektoreve etj. si dhe analiza e ecurisë së programit dhe vlerësimi i arritjes së objektivave të tij.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 106. Udhëzimi nr. 31 dt. 29.12.2017.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. Janë rreth 159 institucione të tilla vendase dhe të huaja.</p>	<p>Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me një numër të lartë institucionesh homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. Janë rreth 159 institucione të tilla vendase dhe të huaja.</p> <p><i>Aneks 72. Liste MoU per publikim.</i></p> <p><i>Aneks 71. List of IIA InterInstitution Agreement.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partnerëve vendas të UAMD/FSHPJ/DAP janë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Spitali Rajonal Durrës; ● Kuvendi i Shqipërisë; ● Këshilli i Qarkut Durrës; ● KLSH; ● Akademia e Sigurisë; ● Autoriteti Portal Durrës; ● Qendra Gratë në Shërbim; ● Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë; ● Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës, etj. <p><i>Aneks 72. Liste MoU per publikim.</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>DAP, njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të marrë në vlerësim, dëshmon se harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, të cilat kanë organizuar sesione edukuese, workshop/e dhe bashkëbisedime me të ftuar të fushës me qëllim aftësimin dhe angazhimin e studentëve në mënyrë aktive.</p> <p><i>Aneks 95. Analiza dhe Raporti vjetor i DAP dhe programit të studimit 2021-2022</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ nga vlerësimi i Aneksve dhe vizita në ambientet shprehet se Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit dhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Përcaktimet e Ligjit Nr. 80/2015 për IAL janë pasqyruar në Statutin e UAMD ku në nenin 58 “Ciklet dhe programet e studimeve” përcaktohet se programet e studimeve organizohen në module dhe vlerësohen në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimin nr. 31 të MAS, si dhe VKM 41 me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Në Rregulloren e programit të Administrim Publik, Neni 13 “Format e mësimi” përcaktohet se programi i studimit organizohet në cikle dhe përfundon me marrjen e diplomës. UAMD ofron programe semestrale të studimeve të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të krediteve (USCr). Në Nenin 16 theksohet se në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në përputhje me parimet e Procesit të Bolonjës, studimet universitare të ciklit të parë nuk mund të jenë të plota pa fitimin e të paktën 180 ECTS në jo më pak se 3 vite akademike, në përfundim të të cilave studentet pajisen me Diplomë Bachelor dhe Sistemit Amerikan të krediteve (120 USCr).</p> <p>Gjithashtu, në rregulloren e DAP, Neni 32 theksohet se Departamenti i Administrimit Publik ofron programe të studimeve, të organizuara në module/lëndë dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemin Amerikan UsCr. Vlerësimi shprehet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemit Amerikan të Krediteve, për të krijuar lehtësi lexueshmërie, transferimi dhe vazhdimi të studimeve universitare në universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Programi</p>

	<p>i studimit të ciklit të parë Bachelor në Administrim Publik i referohet nivelit 6 të studimeve sipas Kornizës shqiptare të Kualifikimeve. <i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Aneks 106. Udhezimi nr. 31 dt. 29.12.2017</i> <i>Aneks 110. VKM nr 41 date 24.1.2018</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit te studimit bachelor administrim publik.</i> <i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor Administrim Publik synon të përgatisë specialistë të aftë të mbulojnë detyra në sektorin publik ashtu siç edhe në atë pjesë të sektorit privat në pozicione që lidhen me qeverisjen dhe administratën publike. Ky program synon të ofrojë një realizim të plotë të koncepteve në fushën e administrimit publik dhe të analizojë rolin e sektorit publik në zhvillim dhe lidhjet e tij me fusha të tjera, si dhe ka si mision të përgatisë studentë të cilët të aftësohen në hartimin e politikave publike brenda strukturave që lidhen direkt dhe indirekt me administratën publike qendrore dhe lokale. Programi synon të aftësojë studentin në njohjen e fenomeneve ekonomike nën rregullatorët politik. Ndër objektivat kryesorë të programit mund të përmendim pajisjen e studentëve me njohuritë mbi zbatimin e politikave publike dhe menaxhimin e sektorit publik, sipas praktikave bashkëkohore e ndërkombëtare dhe përvojës e eksperiencës shqiptare në fushën e Administrimit Publik. <i>Aneks 61. plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke u referuar materialit mbi programet e studimit, rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh në 3 vjet në total 180 kredite. Struktura e studimeve për ciklin e parë të studimeve përfshin: a) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme; b) Lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij; c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe gruplëndë me zgjedhje; d) Lëndë plotësuese, të fokusuar në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Bazuar në dokumentin Aneks 110. VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndrushuar, veprimtaritë formuese përcaktohen si më poshtë: A. Lëndë Bazë 15-20%;</p>

	<p>B. Lëndë karakterizuese 50-55%;</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese 12-15%;</p> <p>D. Lëndë plotësuese 10-15%;</p> <p>E. Detyrime përmbyllëse 3-5%.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit për kriterin 6, tregojnë se programi i studimeve të ciklit të parë Bachelor në Administrim Publik, ka të specifikuar veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit”, i ndryshuar, ku vërehet se kategoritë e programit thuajse përputhen me përcaktimet lidhur me ngarkesën respektive në kredite.</p> <p><i>Aneks 60. Curricula bachelor administrim publik.</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, programi i studimit e ka të përcaktuar ngarkesën në kredite dhe sipas kategorive të veprimtarisë (A-E).</p> <p><i>Programi i studimit nuk ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale. GVJ rekomandon futjen e Praktikës Profesionale në planin mësimor.</i></p> <p><i>Aneks 61. plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar.</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Referuar dokumentit “Aneks 128. Urdhër për trajtimin me bursë të studentëve nga shtresat në nevojë” konstatohet se është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga studentët e ciklit të parë dhe të dytë, të cilët përjashtohen nga tarifa e shkollimit ose trajtohen me bursë. Në bazë të këtij dokumenti, përfaqësuese e FSHPJ për vitin akademik 2022-2023 është Znj. R.B.</p> <p><i>Aneks 128. Urdhër për trajtimin me bursë të studentëve nga shtresat në nevojë.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Administrim Publik” është një program ndërdisiplinor që i përket fushës së studimit të shkencave sociale. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ofrojnë mësim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, dhe forma të kontrollit të vazhdueshëm. Referuar dokumentit “Plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar” (Aneksi 61), janë analizuar dhe organizuar në % dhe krahasuar me përcaktimet në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar.</p> <p><i>Aneks 61. Plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar.</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit Bachelor Administrim Publik.</i></p> <p><i>Aneks 110. VKM nr 41 date 24.1.2018.</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga</p>	<p>Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit që formohet</p>

ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	sipas shkronjave të emërimit të programit dhe emërimit të secilës lëndë. <i>Aneks 35. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD.</i> <i>Aneks 36. Kodifikimi Programeve 2022.</i>			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në Administrim Publik ofrohet vetëm nga DAP/FSHPJ. <i>Aneks 61. plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar.</i> <i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Neni 51.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ nga vlerësimi i Aneksve dhe vizita në ambientet shprehet se Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, ofron programe të studimeve të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit nuk ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale. GVJ rekomandon futjen e Praktikës Profesionale në planin mesimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Bachelor në "Administrim Publik" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, si njësi kryesore dhe Departamenti i Administrimit Publik, si njësi bazë. Nga dokumentet e ofruara rezulton se Departamenti i Administrimit Publik, për vitin akademik 2022-2023, ka gjithsej 31 pedagogë, nga të cilët 14 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin "Profesor", 3 kanë titullin "Profesor i Asociuar", 6 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 janë Asistent Lektorë me Msc; dhe 17 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin "Profesor", 3 kanë titullin "Profesorë të Asociuar", 1 ka gradën Dr./PhD, dhe 12 janë Asistent Lektorë me Msc dhe në proces Dr. Në vitin akademik 2021-2022, departamenti përbëhej gjithsej nga 29 pedagogë, nga të cilët 14 pedagogë efektiv (PAE) ku: 1 ka titullin "Profesor", 2 kanë titullin "Profesor i Asociuar", 7 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 janë Asistent Lektorë me Msc; dhe 15 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin "Profesor", 3 kanë titullin

	<p>“Profesorë të Asociuar”, 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 8 janë Asistent Lektorë me Msc dhe në proces Dr.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021, departamenti përbëhej gjithsej nga 43 pedagogë, nga të cilët 15 pedagogë efektiv (PAE) ku: 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD, dhe 4 janë Asistent Lektorë me Msc; dhe 28 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 kanë titullin “Profesor”, 4 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 5 kanë gradën Dr./PhD. dhe 17 janë Asistent Lektorë me Msc dhe në proces Dr.</p> <p>Për sa më sipër, njësia bazë përgjegjëse për programin (DAP), përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për: numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, si dhe organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit ‘‘Aleksandër Moisiu’’ Durrës.</i></p> <p><i>Aneks shtesë gjatë vizitës, tabela 2.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>DAP, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka hartuar një manual të detajuar për zhvillimin e programit, por nuk ka të parashikuar praktikën profesionale në kurrikulën e programit. Sikurse cituar edhe më lart, në standardin II.1, kriteri 4, <i>GVJ rekomandon futjen e praktikës profesionale në planin mësimor. UAMD, në tabelën 2 të stafit të departamentit, ka përfshirë dy anëtarë të personelit ndihmës-akademik në pozicionin e sekretarit mësimor, por që nuk i referohen personelit ndihmës akademik/akademik për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike, klinike, etj., sikurse kërkohet nga ky kriter.</i></p> <p><i>Aneks 61. plani mesimor bachelor aministrim publik i riorganizuar.</i></p> <p><i>Aneks shtesë gjatë vizitës, tabela 2.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Referuar dokumentit “Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit” njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, edhe studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik konfirmuan ruajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me koordinatorin e programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 98 Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>DAP përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike. Për vitin akademik 2022-2023, departamenti përbëhet nga 31 pedagogë efektivë dhe 17 pedagogë me kontratë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Në dokumentin Rregullore DAP, në Nenin 64 “Mbrojtja e Diplomës”, përcaktohet se diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi.</p> <p>Studentët të ciklit të parë të studimeve, me mesatare mbi 7 kanë të drejtën të realizojnë temë diplome, ndërsa studentëve poshtë mesatares 7 i bëhet i detyruar provimi i diplomimit. Tezat e diplomës udhëhiqen nga punonjësit mësimorë shkencorë të DAP që kanë titull ose gradë shkencore. Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga Departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani.</p> <p>Në FSHPJ, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p>Bazuar në dokumentet e mësipërme, FSHPJ/DAP përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë të marrë në vlerësim, dëshmojnë se disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> <p><i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar.</i></p> <p><i>www.uamd.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Administrim Publik përmban informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, tipin e veprimtarisë mësimore dhe komponentë të tjerë.</p> <p>Në dokumentin “Rregulloren e studimeve të FSHPJ” përcaktohen qartë kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit si dhe format e kontrollit të dijeve. Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik mes të tjerash, përfshihet informacion për mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. Për veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit mes të tjerash specifikohet vlerësimi i dijeve të përfituara që përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar, i cili mund të jetë provim, por jo vetëm.</p> <p><i>Aneks 61. plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar.</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme</p>	<p>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit e ekuivalentimit të studimeve. Kriteret për pranimin e studentëve që ndjek UAMD për këtë program</p>

dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	studimi janë të pasqyruara në Rregulloren e UAMD-së, po ashtu edhe procesi i transferimit të studentëve nga IAL të tjera drejt UAMD dhe anasjelltas si dhe ekuivalentimi i krediteve të fituara. <i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Aneks121. Nje praktike transferimi DAP.</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Gjatë takimit me pedagogët në institucion u argumentua prej tyre se programet e lëndëve janë subjekt rishikimi para çdo viti akademik me qëllim përditësimin e tyre. Në program gjendet informacioni në lidhje me objektivat e lëndës, temat e lëndës, formatet e kontrollit të dijeve dhe mënyra e vlerësimit. <i>Aneks 115. Syllabuset 2022-2023 Administrim Publik.</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga vizita në institucion nga takimi me stafin e DAP u theksua se programet janë hartuar me qëllim që studentët të arrijnë njohuritë e nevojshme të cilat mundësojnë formimin teoriko-profesional, në përshtatje të plotë me tregun e punës. Departamenti i Administrimit Publik i kushton një rëndësi të veçantë përditësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit dhe ndryshimet e mundshme miratohen sipas përcaktimeve ligjore. FSHPJ/DAP janë të vetëdijshëm për nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të programit të marrë në vlerësim. <i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ. Aneks 83.1. Vendimet e senatit akademik ndryshimet e kurrikulave nën 20% 2022.</i>			
Konkluzione	<i>Dokumentet e përcjella dhe diskutimi gjatë vizitës në institucion, mbi praktikën konkrete që ndërmerr institucioni për përmirësimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik, dëshmojnë se përmbajtja e këtij programi është në proces përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive	Nga dokumentacioni dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit është e organizuar në 3 vite akademike, me 180

<p>dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>kredite në total dhe është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Përmbajtja e programeve të studimit, shpërndarja e lëndëve gjatë të gjithë ciklit të studimit, mundësojnë për studentët e UAMD, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, thellim të njohurive dhe aftësive të tyre në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Programi Bachelor në “Administrim Publik” duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale, mundëson punësimin e të diplomuarve në mënyrë të veçantë edhe në përputhje me emërtimin e tij në sektorin publik, por gjithashtu mundëson punësim edhe në sektorin privat konform Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë”.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u theksua se studentët kanë vijueshmëri studimesh, rreth 80-90% e tyre vazhdojnë në master, ku shumica janë në administratë publike, por ka dhe në sektor privat. Ka studentë që punojnë dhe jashtë fushe. Rreth 80% e studentëve janë tëpunësuar, ku rreth 60% në profesion.</p> <p><i>Aneks 85. STUDIMI I TREGUT TE PUNES ADMINISTRIM PUBLIK</i> <i>Aneks 87. Anketa studente bachelor Administrim Publik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar në vizitën e GJV dhe dokumentacionit të paraqitur, plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Administrim Publik” është hartuar në bazë të Kuadrit Kombëtar dhe European të studimeve, është organizuar të ketë shtrirje përgjatë 6 semestrave me kohëzgjatje normale 15 javë për secilin semestër. Lëndët bazë të detyrueshme janë lëndë të cilat i ofrojnë studentit njohuri dhe përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme ndërsa lëndët karakterizuese janë lëndë të cilat ofrojnë përgatitje teorike dhe profesionale për fushën e studimit. Të treja vitet akademike përbajnë nga 60 kredite (gjithësej 180 kredite). Ngarkesa mësimore për këtë program studimi është 4500 orë mësimore prej të cilave 1350 orë mësimore në auditor dhe 3150 orë mësimi individual të studentit me një total (180 ECTS), duke e përafëruar këtë program studimi me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Aneks 92. Vendim DAP per ndarjen e lendeve sipas fushave.</i> <i>Aneks 95. Analiza dhe Raporti vjetor i DAP dhe programit te studimit 2021-2022.</i> <i>Aneks 61. plani mesimor bachelor aministrim publik i riorganizuar.</i> <i>Aneks 64. Orari bachelor FSHPJ sem pare 2022-2023.</i> <i>Aneks 110. VKM nr 41 date 24.1.2018.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në Planin Mësimor të programit të studimit të marrë në vlerësim janë pasqyruar lëndët, të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si dhe në vite e semestra, dhe me kreditet përkatëse. Çdo lëndë në Planin Mësimor e parashikuar për t’u zhvilluar në auditor, përbëhet nga komponentët mësimorë si leksione dhe seminare.</p>

	<p><i>Në planin mësimor mungon praktika profesionale, ndaj GJV rekomandon futjen e praktikës profesionale në planin mësimor për këtë program studimi, si një kriter i rëndësishëm me qëllim që të përmbushen standardet e cilësisë dhe në nivel evropian.</i></p> <p><i>Aneks 61. plani mesimor bachelor administrim publik i riorganizuar.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të ofruar, rezulton se kurríkula e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik garanton pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në lidhje me metodat, teknikat dhe instrumentat që u vijnë në ndihmë për të arritur objektivat e synuara.</p> <p>Gjatë takimit në institucion me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit, u konstatua sipas tyre se studentët kanë vijueshmëri studimesh, rreth 80-90% e tyre vazhdojnë në Master, rreth 80% e studentëve janë të punësuar, gati 60% në profesion, shumica janë në administratë publike, por ka dhe në sektor privat sepse një nga qëllimet është dhe ajo pjesë e sektorit privat të kompanive ku ka lidhje me shtetin, tatimet, taksat, OJQ, etj. Gjithashtu, sipas tyre ka edhe studentë që punojnë jashtë fushe, por e kanë të lehtë të ndjekin punësimin e tyre edhe në bashkëpunim me zyrën e alumni.</p> <p><i>Aneks 95 Analiza dhe Raporti vjetor i DAP dhe programit të studimit 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 85 Studimi i tregut të punës administrim publik 2021.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>DAP i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes dhe miratimit të syllabusit në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët e DAP u konstatua se syllabuset çdo fillim semestri rishikohen dhe miratohen në departament, por sipas tyre, mund të ketë edhe raste kur del nevoja të rishikohen gjatë viti.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me Dekanin, Përgjegjësin e Departamentit dhe stafin akademik të programit.</i></p> <p><i>Evidenca 115 dhe 115.1, syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe diskutimet në institucion vihet re se lëndët që realizohen në këtë program studimi fokusohen në formimin e punonjësit në administrim publik. Në përputhje me objektivat për programe studimi të ciklit të parë, programi i studimit Bachelor në “Administrim Publik” synon të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme teoriko – profesionale. Ky program studimi i cili ka synim që të përgatisë specialistë të aftë për administratën publike është i hartuar në mënyrë të tillë që i krijon mundësi studentëve të regjistruar të përfitojnë dijet, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të hyrë në tregun e punës apo për të vijuar studimet në një cikël më të lartë.</p> <p>Nga kjo pikëpamje, përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>

	<i>Aneks 61. plani mesimor bachelor aministrim publik i riorganizuar.</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga diskutimet e vizitës në institucion vihet re Institucioni dhe Departamenti i Administrimit Publik ka mundësuar që përmes përmbajtjes së programeve të studimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerët, studentët të kenë mundësi të vijimësisë së studimeve dhe punësimin e tyre duke iu përshtatur nevojave të tregut. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët e DAP u konstatua se një pjesë e mirë e tyre kishin përfunduar studimet në këtë program studimi. Në takimet e realizuara në kuadër të vizitës në institucion, drejtuesit, por edhe pedagogët deklaruan se kanë kontakte me studentë të diplomuar në këtë program studimi. <i>Aneks 61. plani mesimor bachelor aministrim publik i riorganizuar.</i>			
Konkluzione	<i>Përmbajtja e programit të studimit të marrë në vlerësim garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Bazuar në të dhënat e mbledhura mund të thuhet se përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës brenda dhe jashtë vendit. Në planin mesimor mungon praktika profesionale, ndaj GJV rekomandon futjen e praktikës profesionale në planin mesimor për këtë program studimi, si një kriter i rëndësishëm me qëllim që të përmbushen standardet e cilësisë dhe në nivel evropian.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Për arritjen e objektivave formuese dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit Bachelor në Administrim Publik, FSHPJ/DAP, si pjesë përbërëse e UAMD-së, dëshmojnë përmes dokumenteve "Liste MoU" se kanë vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione publike e private. Departamenti i Administrimit Publik është i përkushtuar për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit Bachelor në "Administrim Publik". "Plani i Zhvillimit Strategjik – 2016-2020" i UAMD, Kreu VIII, përcakton dy targete: rritje e numrit të projekteve të përbashkët me impakt rajonal me dhe për komunitetin,

	<p>si dhe rritje e numrit te veprimtarive te përbashkëta, ne organizime me Alumni, që ndikojnë komunitetin.</p> <p><i>Aneks 72. Liste MoU per publikim.</i></p> <p><i>Aneks 12. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD (2016-2020).</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mundëson monitorimin e punësimit të diplomuarve të vet, nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar dhe nëpërmjet krijimit të një database për të parë se sa përputhet formimi që marrin me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>DAP, në kuadër të politikave të UAMD, synon rritjen e përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të universitetit.</p> <p>DAP ka hartuar dhe aplikon një pyetësor për studentët me anë të të cilit vjel propozimet e studentëve për përmirësimin e programit të studimit Bachelor “Administrim Publik”. Këto propozime janë konsideruar gjerësisht nga DAP gjatë periudhës së riorganizimit të programeve të studimit. Po ashtu në nivel universiteti, një segment i pyetësorit për studentët trajton edhe perceptimin e tyre për programet e studimit</p> <p><i>Aneks 18. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrieres.</i></p> <p><i>Aneks 87. Anketa studente bachelor Administrim Publik.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>DAP si struktura përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik reflekton në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit bazuar në kërkesat e tregut të punës dhe partnerëve.</p> <p>Në këtë mënyrë, DAP organizon takime konsultative dhe konferenca që përfshijnë edhe përfaqësues të institucioneve qëndrore dhe lokale në mënyrë që të përshtasë programet studimore sa më shumë të jetë e mundur me nevojat konkrete të administratës publike, në nivel qëndror dhe nivel lokal.</p> <p><i>Aneks 87. Anketa studente bachelor Administrim Publik.</i></p> <p><i>Aneks 17. Planifikimi Strategjik DAP 2020-2025.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion, GVJ konkludon se DAP reflekton në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit duke marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e UAMD” përcaktohet se në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. Ato mund të jenë të ndërthurura në orë leksioni; orë seminari; orë mësimi të integruara të leksioneve me seminarët; orë ushtrime; orë laborator; projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; në formën e seancave individuale në auditor, si veprimtari të tjera të zhvilluara në laboratorë të Fakultetit.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët dëshmohet se sistemi i transmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet, seminarët, të cilat organizohen në mënyrë interaktive duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit. Gjithashtu, një formë tjetër e transmetimit të dijeve është edhe përfshirja e studentëve në konferenca kombëtare/ndërkombëtare të organizuara nga FSHPJ dhe DAP, orë mësimi të hapura, konsultime tematike dhe veprimtari të tjera të miratuara nga institucioni.</p> <p><i>Aneks2. Rregullore UAMD, neni 40, “Elementët e studimeve” fq. 21-22.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Stafi akademik i FSHPJ/DAP ka përfutuar ndër vite nga projekte të mobilitetit dhe trajnimet në fushën e mësimdhënies në AL, duke pasuruar dhe përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies, si dhe duke ofruar metoda dhe mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në AL, të cilat janë në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p>Referuar komunikimit me stafin akademik gjatë vizitës në institucion mësohet se stafi akademik suportohet nga UAMD për çdo aktivitet apo projekt kërkimor.</p> <p>Gjatë viteve 2016-2022 kanë marrë pjesë në trajnime dhe mësimdhënie 53 nga stafi akademik dhe studentë.</p> <p><i>Aneks 70. FSHPJ DAP Databaza Erasmus+mobilitete personel akademik dhe studente.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UAMS (FSHPJ/DAP) mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike.</p> <p>Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UAMD lidhet me trajnimin e pedagogëve për t’u njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe</p>

	<p>transmetimit të dijës, të cilët marrin pjesë në program Erasmus+, si dhe mobilitet të personeleve akademike dhe ndihmës akademike pranë universiteteve partnere.</p> <p><i>Aneks 70. FSHPJ DAP Databaza Erasmus+mobilite personel akademik dhe studente.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion me studentët dhe stafin akademik, GVJ mësoi se procesi i mësimdhënies dhe të nxëniet në DAP realizohet në një klimë pozitive. Pedagogët respektojnë lirinë e mendimit të studentëve, duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë dhe të menduarit kritik e krijues të tyre. Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi nga takimi me studentët, se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies për lehtësimin e të kuptuarit nga studentët.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Duke u bazuar në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnime dhe pjesëmarrje në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë.</p> <p>Në të njëjtën kohë, studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndës në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës. Gjatë takimit me studentët u konstatua se në përfundim të lëndës/modulit personeli akademik realizon me studentët pyetësorë për vlerësim, ku merren parasysh mendimet dhe sugjerimet e studentëve për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies. Një vëmendje e veçantë u jepet studentëve me aftësi të kufizuar.</p> <p><i>Aneks 20. Rregullore për Studentët me Aftësi të kufizuar.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik</p>	<p>UAMD dhe njësitë përbërëse të saj kanë organizuar struktura në disa nivele, të cilat harmonizojnë dhe koordinojnë punën për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënien.</p> <p>Bazuar në informacionin e siguruar gjatë vizitës në DAP, GVJ konstaton se UAMD në zbatim të kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka vënë në funksion struktura.</p> <p>Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC); - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL); - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC);

<p>për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti); - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.); - Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc. <p>Përfshirja e personelit akademik në aktivitete shkencore dhe programet e shkëmbimit janë një proces që i shërben personelit akademik gjithashtu edhe për përmirësimin e tij në mësimdhënie dhe në zbatimin e metodave të reja.</p> <p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” është pjesë e projektit mbi përdorimin e Moodle.</p> <p><i>Aneks 23.1 Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka ngritur organet, autoritetet dhe strukturat/njësitë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat kanë si funksion të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. UAMD garanton procesin e të nxënësve, aftësimin profesional e shkencor me metoda dhe praktika me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në dokumentin Rregullore DAP, Neni 56, “Kontrolli i dijeve”, përcaktohen kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve. Forma e vetme e kontrollit të dijës në Fakultetin e Shkencave Politiko Juridike është provimi me shkrim. Për çdo kurs 10% e vlerësimit bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, dhe esetë, sipas programit të lëndës së miratuar.</p> <p>Në Nenin 64 të kësaj Rregulloreje, “Mbrojtja e Diplomës”, përcaktohet se diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi.</p> <p>Studentët të ciklit të parë të studimeve, me mesatare mbi 7 kanë të drejtën të realizojnë temë diplome, ndërsa studentëve poshtë mesatares 7 i bëhet i detyruar provimi i diplomimit. Tezat e diplomës udhëhiqen</p>

	<p>nga punonjësit mësimorë shkencorë të DAP që kanë titull ose gradë shkencore. Vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga Departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani.</p> <p>Në FSHPJ, kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> <p><i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve/moduleve që zhvillohen në programin Bachelor në Administrim Publik, në kategorinë “Forma e kontrollit të dijes dhe frekuentimi”, është përshkruar metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve (Programet mësimore të lëndëve të programit Bachelor në Administrim Publik). Në fillim të çdo lënde, titullari i lëndës informon studentët rreth përmbajtjes së programit lëndor dhe mënyrës së testimit/vlerësimit.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i></p> <p><i>Evidenca 115 dhe 115.1, syllabuset.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë gjatë gjithë semestrit/vitit, të ndihmojë hap pas hapi studentin që të përmirësohet dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv. Në dokumentin “Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik” shkruhet se sasia mesatare e krediteve të grumbullura gjatë një viti nga një student është 60 kredite. Një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75% - 100%. Nëse studentit mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe arrin kuotën 25% të mungesave, ose është i pranishëm gjatë gjithë kursit por nuk merr pikët e mjaftueshme për të kaluar kursin, ai përsërit lëndën në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet.</p> <p>Procesverbali me notat përfundimtare nënshkruhet nga personeli akademik, sekretarja mësimore, kryesekretarja, përgjegjësi i departamentit dhe dekani. Në rastet e hedhjes së pikëve gabim, personeli akademik i drejtohet me kërkesë Drejtuesit të Njësisë Kryesore i cili pasi e miraton ja përcjell kryesekretares për veprim.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët u vu re se studentët ishin të kënaqur nga vlerësimi i pedagogëve.</p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me personelin akademik u theksua se ata testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë të të nxënimit përmes një ndërveprimit të vazhdueshëm me studentët dhe nevojat e tregut të punës. Stafin akademik aplikon metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur</p>

reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	teknologjinë e informacionit që mundësohet edhe nga institucioni. (Platforma Link: http://moodle.org/).			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	FSHPJ/DAP si pjesë e UAMD-së, mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Bazuar në Evidencën 70 për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UAMD lidhet me trajnimin e pedagogëve. Personeli akademik përfiton mundësi nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe për tu njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. <i>Aneks 70. FSHPJ DAP Databaza Erasmus+mobilitete personel akademik dhe student.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion evidenton se UAMD-ja harton rregullore dhe procedura të posaçme mbi testimin e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, si dhe garanton zbatimin e tyre. Gjithashtu, Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i studentit në një lëndë të caktuar realizohet gjatë gjithë semestrit/vitit akademik dhe ka qëllim të nxisë studentin që të mësojë gjatë gjithë semestrit/vitit, të ndihmojë hap pas hapi studentin që të përmirësohet dhe të sigurohet një vlerësim përfundimtar sa më objektiv. Duke u bazuar tek dokumentet, rezultati përfundimtar reflekton vlerësimet e realizuara gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës, duke u bazuar në një sistem pikëzimi, i cili bëhet në mënyrë individuale nga secili pedagog, në varësi të natyrës që ka lënda. <i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i> <i>Aneks 115.1 Syllabus Bachelor AP 2018-2022.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat	Në kushtet e pandemisë globale, testimi është zhvilluar përmes sistemit elektronik si Google Classroom, Zoom.

<p>shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur format e ndryshme të abuzimit, institucioni ka zbatuar projekte pilot për testimin e sistemeve elektronike me bazë kodimin e tezave të studentëve dhe aktualisht, aplikon projektin Clean Score sipas marrëveshjes midis Albanian – American Development Foundation dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në Shkurt 2019.</p> <p><i>Aneks 120. Nje praktike vleresimi me Clean Score.</i></p> <p><i>Aneks 119. Marreveshje me AADF CleanScore Universiteti Aleksander Moisiu Durres.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet duke testuar përvetësimin e dijeve të studentit për të gjitha temat e trajtuara e të pasqyruara në syllabusin e secilës prej lëndëve të zhvilluara gjatë semestrit. Vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet duke hedhur në hapësirën përkatëse të secilës lëndë në sistemin elektronik “Pitagora” nga ana e pedagogut të lëndës vlerësimet e studentit në përfundim të secilit provim (provimi i ndërmjetëm dhe ai përfundimtar) dhe pas ballafaqimit me studentët për vlerësimet e tyre së bashku me vlerësimet për detyrën e kursit.</p> <p>Në sistemin “Pitagora” studenti nëpërmjet llogarisë së tij personale mund të shohë notën përfundimtare të lëndës e cila llogaritet nga mbledhja e pikëve të marra në provimet përkatëse dhe detyrën e realizuar gjatë semestrit për secilën lëndë. Rezultati përfundimtar konvertohet në notë.</p> <p><i>Aneks 44. MANUAL-PEDAGOGU PITAGORA.</i></p> <p><i>Aneks 45. Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nxënësit vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme përmes diskutimeve në klasë, detyrave dhe provimeve. Vlerësimi i vazhdueshëm i ndihmon studentët të kuptojnë ku kanë vështirësi ose boshllëqe, si mund të përmirësojnë përvetësimin e modulit/lëndës dhe u siguron lektorëve të dhëna në lidhje me mësimdhënien efektive.</p> <p>Nga takimi në institucion me personelin akademik, GVJ mësoi se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale mund të shoqërohet me komente nga pedagogu përkatës (nëse është e nevojshme), për të sqaruar studentin dhe ndihmuar atë që të përmirësohet në të ardhmen. Kjo procedurë realizohet në kuadër të konsultave, të cilat janë të detyruara për pedagogun dhe realizohen menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe shpalljes së rezultateve.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me personelin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik respektojnë Rregulloren e UAMD dhe Kodin e Etikës së UAMD mbi evitimin e plagjiaturës dhe kopjimit.</p> <p>Ata orientojnë studentët lidhur me literaturën e nevojshme si dhe këshillojnë kryerjen e detyrës së kursit dhe temës së diplomës duke i konsideruar këto masa të nevojshme për të evituar plagjiaturën.</p>

	<p><i>Infrastruktura logjistike që mund të sigurojë plotësisht këtë proces mungon dhe kjo detyrë kërkon të garantohet në Universitetin infrastruktura e nevojshme për kontrollin e plagjiaturës.</i></p> <p>Pedagogu bën një vlerësim të detajuar dhe të argumentuar të cilësive të detyrave të kursit (individuale apo në grup), sipas komponentëve të zhvillimit të tyre. Ky vlerësim i shërben studentit për të kuptuar se si mund të përmirësojë punën e tij. Çdo anëtar i komunitetit akademik është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë.</p> <p><i>Aneks 32. Kodi i Etikës UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>FSHPJ/DAP bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë dhe të jepen në kohën e përcaktuar. Nga takimi në institucion u kuptua se pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, prezantime në grup ose individuale, etj. Diversiteti i formave vlerësuese u jep mundësi pedagogëve të vlerësojnë saktë njohuritë e përfituara nga studentët nga ndjekja e programit. Procesverbalet e vlerësimit dorëzohen në Sekretari në afatet e përcaktuara qartë në Rregulloren e UAMD-së dhe Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 31 Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>UAMD/FSHPJ garanton bazuar në dokumentet e saj rregullatore, të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës. Rregullorja e Përgjithshme e UAMD dhe Rregullorja e programit të studimit garantojnë të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe të drejtën për rishikim të vlerësimit në bazë të një procedure të përcaktuar qartë.</p> <p>Duke u bazuar në Rregullore, ankimimi ose kërkesa shqyrtohet duke respektuar procedurat që përcakton Rregullorja e UAMD-së dhe dokumentacioni dorëzohet në Sekretarinë e Fakultetit, e cila administron dokumentacionin sipas ligjshmërisë në fuqi. Në rast ankimimi në lidhje me vlerësimin e provimit komisioni ad/hoc mblidhet në prejencë të studentit duke e bërë këtë proces në mënyrë totalisht transparente.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 31 Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>FSHPJ/DAP, bazuar në dokumentet e saj rregullatore, garanton të drejtën e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim/përmirësim të vlerësimit përkatës. FSHPJ/DAP bazohet në rregulloret përkatëse për të siguruar që rezultatet e kontrollit të dijeve</i></p>

	<p>dhe aftësive profesionale të studentëve të bazohen në meritë dhe të jepen në kohën e përcaktuar.</p> <p>Infrastruktura logjistike që mund të sigurojë plotësisht procesin e shmangies së kopjimit mungon, pasi nuk ka një sistem antiplagjiaturë dhe kjo detyrë kërkon të garantohet në Universitet infrastruktura e nevojshme për kontrollin e plagjiaturës.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Administrim Publik është dizenuar për të përgatitur studentët për arsimim të mëtjshëm. Programi i studimit “Bachelor në Administrim Publik” i prezanton studentët me mundësi për të eksploruar dhe thelluar njohuritë e tyre. Programi përpiket që të përforcojë aftësitë analitike, prezantuese, aftësitë negociues dhe menaxhuese në situata konkurruese, të fitojnë aftësi të punës në grup etj. Programi i studimit Bachelor në “Administrim Publik” ka si synim diplomimin e studentëve të kualifikuar e të aftë për t’u punësuar si specialistë të administratës publike.</p> <p>Programi realizohet nga një staf akademik i kualifikuar me grada dhe tituj akademik, ose Msc., si dhe me përvojë në fushën e kërkimit,</p> <p><i>Aneks 114 CV DAP.</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mesimor bachelor aministrim publik i riorganizuar.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Institucioni dëshmon se angazhohet dhe krijon kushte në mbështetje të programit të studimit me qëllim që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, përmes trajnimit të studentëve për të përdorur sistemin MOODLE për qëllime mësimore. Lëndët/modulet si Metodatat Sasiore në Analizën e Politikave, Politika Publike Krahasuese, Politika dhe Politikat Publike, Demokracia, Politika dhe Institucionet, E Drejtë Publike e Krahasuar, etj., garantojnë dhe sigurojnë zhvillimin e njohurive dhe aftësive të veçanta në plotësim të objektivave të programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 60. Kurrikula bachelor administrim public.</i></p> <p><i>Aneks 61. Plani mesimor bachelor aministrim publik i riorganizuar.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më</p>	<p>Bazuar nga takimi me stafin akademik në institucion, GVJ mësoi se pedagogët e çdo lënde në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizojnë seanca konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orientojnë studentin për provimin përfundimtar. Çdo pedagog analizon në përfundim të lëndës çështje të perditësimi të temave mësimore që kanë të bëjnë me kompleksitetin dhe sigurimin e njohurive komplementare për njohuri të plota dhe</p>

<p>të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>profesionale të studentëve. Në grupet mësimore diskutohen çështje të ndryshme për përmirësimin në vazhdimësi të syllabus-it. Çështje të veçanta të përmirësimit në vazhdimësi të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, diskutohen edhe në Departament. Studentët orientohen për testin përfundimtar nga pedagogu i lëndës/modulit i cili bën një përsëritje të koncepteve dhe çështjeve më të rëndësishme të modulit/lëndës; gjithashtu lektori vë në dispozicion të studentëve edhe fondin e pyetjeve për testin përfundimtar dhe orarin e konsultimeve. <i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Stafi akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Administrim Publik është i kualifikuar dhe i prirur për të realizuar një mësimdhënie mbi bazë kompetencash duke u dhënë mundësi studentëve të zhvillojnë dhe aplikojnë njohuritë e marra në praktikat e tyre profesionale. Kjo prirje gjen pasqyrim në hartimin e programeve lëndore dhe shprehet në mënyrë të veçantë në formulimin e rezultateve të pritshme të të nxënimit që parashikohen të arrijnë studentët në përfundim të programit. Në strategjinë e UAMD-së përcaktohet qartë fokusi tek studentit dhe studentët në qëndër të procesit mësimor. Personeli akademik është i motivuar të komunikojë në mënyrë efektive me studentët, është i orientuar plotësisht për studentin në qëndër të gjithë procesit mësimor dhe krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve të reja, duke i nxitur studentët për punë kërkimore. Për të gjitha çështjet që lidhen me mbështetjen dhe komunikimin me studentët, personeli akademik monitorohet dhe pyetëtori që plotësojnë studentët në përfundim të lëndës/modulit i shërben përmirësimit të këtij aspekti të rëndësishëm të punës tonë në vazhdimësi. <i>Aneks 87. Anketa studente bachelor Administrim Publik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi çështje që lidhen me situatën dhe problemet aktuale të shoqërisë. Seminaret zhvillohen në mënyrë interaktive, me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë gjykime të vlefshme, të analizojnë situata dhe të arsyetojnë në mënyrë inteligjente, të formulojnë dhe realizojnë qëllime të caktuara. <i>Aneks 114 CV DAP.</i> <i>Aneks 61. Plani mesimor bachelor aministrim publik i riorganizuar.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit dhe stafin akademik.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD promovon rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Programi zhvillohet në mjedise me një infrastrukture të përshtatshme, të pajisur me teknologji që mbështesin mësimdhënien bashkëkohore.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullore e FSHPJ” (2020) në Nenin 61 “Mbrojtja e diplomës” përshkruhen hollësisht modalitetet e realizimit të provimit final ose mbrojtjes së diplomës. Në të shkruhet: “Diplomimi për Bachelorin bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi ndersa për masterin vetëm me teze diplome”.</p> <p>Po ashtu DAP vendos në dispozicion të studentëve për studentët që kërkojnë të diplomohen në ciklin e parë të studimeve në Administrim Publik, ku përshkruhet në mënyrë të detajuar metodologjia e punimit, struktura, etika e kërkimit, mënyrën e prezantimit, kërkesat teknike etj.</p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 104. Pakete e udhëzime e diplomim bachelor 2022.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>FSHPJ/DAP, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, dhe personeli akademik që mbulon këtë program, asistojnë studentët tyre, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës (konsistuar gjatë vizitës në institucion). Në dokumentin “Rregullore e FSHPJ” (2020) në Nenin 61 “Mbrojtja e diplomës” përshkruhen hollësisht modalitetet e realizimit të provimit final ose mbrojtjes së diplomës.</p> <p><i>Aneks 104. pakete e udhëzime e diplomim bachelor 2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Për zhvillimin e provimit final të diplomimit, DAP ndjek procedura të parashikuara në “Rregullore e e FSHPJ” (2020) ku në Nenin 64 dhe 65 përcaktohet se studentët e çdo programi studimi, që nuk marrin tezë diplome, i përfundojnë studimet me provim të përgjithshëm përfundimtar. Drejtuesi i Njësisë Bazë, për çdo program propozon ngritjen e një komisioni për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të personelit akademik. Vlerësimi përfundimtar i tezës llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit jo më vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit.</p> <p>Më tej në Nenin 64 “Vlerësimi i tezës së diplomës” citohet se mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij, në jo më pak se 10 minuta. Anëtarët e komisionit dhe dëgjuesit në sallë, rezervojnë të drejtën për t’i drejtuar pyetje studentit në lidhje me tezën e diplomës.</p>

	<p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit të marrë në vlerësim tregon se siguron një rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për provimin e përgjithshëm përfundimtar, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët me konsultime, nëse ata kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me lëndët e tyre. Sipas paketës së udhëzimeve, studentët mund të kontaktojnë cilindo profesor apo lektor të listuar në këtë paketë, në mënyrë që të mund të marrin orientimin e duhur për përcaktimin e temës së mikrotezës. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, me anë të nënshkrimit të deklaratës mbi origjinalitetin e punimit. Udhëheqësi shpreh vlerësimin e tij për temën duke plotësuar formularin përkatës.</p> <p><i>Aneks 104. pakete e udhezime e diplomim bachelor 2022.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konsistoi se njësia bazë mund të asistojë studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në varësi të temave dhe fushës së studimit. Të gjitha burimet si pajisje informatike ashtu si edhe biblioteka janë në dispozicion të studentëve për realizimin e temave të tyre kërkimore shkencore.</p> <p><i>Aneks 26. Rregullorja e Bibliotekes UAMD.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të mbrojtjes së diplomës ose provimit përfundimtar studentit vlerësohet me pikë nga Komisioni përkatës. Këto pikë konvertohen më tej në notën përfundimtare të vlerësimit të punimit të diplomës sipas rregullores së UAMD për kontrollin e dijeve. Në bazë të Rregullores së Re të Universitetit "Aleksandër Moisiu" për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimit me 10-të nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta (94%-100%) është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është nota 5 (pesë) (51%-57%).</p> <p><i>Aneks 104. pakete e udhezime e diplomim bachelor 2022</i> <i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Neni 68</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë në bazë të nenit 91, të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë". Në vijim të kërkesës së tij, studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Neni 90.</i></p>

Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në bazë të Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", në Nenin 93 përcaktohet se të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve kryhen duke u bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu".</i>			
Konkluzione	<i>UAMD ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Stafit dhe personeli akademik i programit të studimit të marrë në vlerësim tregon se siguron një rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për përfundimin me sukses të programit duke i ndihmuar studentët për çdo parqartësi që mund të kenë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në Administrim Publik i përshtatet kërkesave të këtij programi studimi. Në këtë program studimi janë angazhuar lektorë dhe asistentë lektorë me tituj dhe grada shkencore, apo Msc., sipas kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, janë parashikuar të gjitha modalitetet që sigurojnë zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Instituconet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" për rekrutimin dhe punësimin e personelit akademik me nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe fushën kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, në vitin akademik 2022-2023, përbëhet gjithsej nga 24 pedagogë, nga të cilët 19 janë pedagogë efektiv (PAE) ku: 2 kanë titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 9 kanë gradën Dr./PhD, dhe 5 janë Asistent Lektorë me Msc; dhe 5 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka gradën Dr. dhe 4 janë Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2021-2022, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, përbëhet gjithsej nga 25 pedagogë, nga të cilët 17 janë pedagogë efektiv (PAE) ku: 2 kanë titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD, dhe 5 janë Asistent Lektorë me Msc dhe proces Dr.; dhe 8 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka gradën Dr., dhe 6 janë Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, përbëhet gjithsej nga 29 pedagogë, nga të cilët 18 janë pedagogë efektiv (PAE) ku: 2 kanë titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 9 kanë gradën Dr./PhD, dhe 5 janë Asistent Lektorë me Msc dhe proces Dr.; dhe 11 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, dhe 10 janë Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike kërkimore e përgjithshme dhe specifike e profesorëve, lektorëve, dhe asistent lektorëve të angazhuar në këtë program studimi është në përputhje të plotë me kërkesat e këtij programi sipas natyrës dhe moduleve që ai ka.</p> <p><i>Aneks 114. CV DAP</i> <i>Aneks 5. Ligji për Arsimin e Lartë 80 2015</i> <i>Aneks 1 & 2. Statuti UAMD</i> <i>Aneks 3 & 4. Rregullore UAMD</i> <i>Aneks 109. Udhezim 29 datë 10.09.2018 për veprimtarinë dhe ngarkesat e personelit akademik</i> <i>Aneks shtese gjatë vizites, tabela 6.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Të dhënat që ka paraqitur Departamenti i Administrimit Publik për planifikimin e ngarkesës për çdo vit akademik dhe për realizimin e ngarkesës mësimore tregojnë qartë respektimin e kornizës ligjore në fuqi.</p> <p>Mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë i angazhuar në këtë program studimi, paraqitet si në vijim:</p> <p>Në vitin akademik 22-23: 84.4% PAE / 15.6% PAK; Në vitin akademik 21-22: 77.4% PAE / 22.6% PAK; Në vitin akademik 20-21: 71% PAE / 29% PAK; <i>Aneks 90 & 91. Të dhënat për planifikimin dhe realizimin e ngarkesës mësimore.</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës, tabela 12.</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion, evidentohet se Departamenti i Administrimit Publik garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Qëndrueshmëria e personelit akademik garantohet nëpërmjet tipologjisë PAE të stafit në këtë program, personel i cili ka kontrata pa afat dhe është i punësuar pranë IAL prej shumë vitesh, si dhe i angazhuar në këtë program që prej ditës së parë që programi është hapur. Procedura për rekrutimin e personelit akademik është e reflektuar në Statutin e Universitetit dhe në konformitet me bazën ligjore dhe aktet normative në fuqi. Institucioni nëpërmjet DBNJPA ndjek në mënyrë rigoroz procedurat në bashkëpunim me Departamentet. Kontrata e punësimit si detyrim ligjor zbatohet në të gjitha punësimet e kryera. UAMD për realizimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik ka angazhuar staf akademik bazuar në parimet e barazisë, në të drejta, detyrime e përgjegjësi për të garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor ku përfshihet edhe mbështetja e personelit administrativ. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, neni 64 për rekrutimin për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik zbatohet rregullorja e UAMD, neni 103.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti i UAMD</i> <i>Aneks shtesë gjatë vizitës, tabela 2 dhe 6.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja për rekrutimin e stafit përmban të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësimor dhe administrativ. I gjithë procesi i rekrutimit dhe vlerësimit konform kritereve të shpallura ndiqet dhe vlerësohet nga drejtoria e specializuar për këtë proces DBNJ, e fillon procesin pasi merr kërkesën nga njësia bazë. Në Statutin e UAMD, Rregulloren e Përgjithshme të UAMD dhe Rregulloret e tjera përcaktohen qartë të gjitha procedurat për rekrutimin të stafit akademik për realizimin e programit të studimit. Përzgjedhja e personelit akademik të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi është bërë sipas nevojave të Departamentit, i cili ka përcaktuar paraprakisht me vendim të veçantë kriteret specifike për vendet e punës. GVJ konfirmon që institucioni ka miratuar dhe zbaton me rigorozitet procedura rekrutimi dhe vlerësimi që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e kërkuar të kualifikimit.</p> <p><i>Aneks 138 Kontrata e punës për personelin akademik</i> <i>Aneks 5. Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015 Neni 64</i> <i>Aneks 3 & 4. Rregullore e UAMD</i> <i>Aneks 1. Statuti UAMD</i> <i>Aneks 142. Vendim i DAP për kriteret e rekrutimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>

<p>për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, siguron punësimin e personelit ndihmës akademik referuar rregullores së institucionit dhe strukturës organizative të tij.</p> <p><i>Aneks 3 & 4. Rregullore e UAMD</i> <i>Aneks 142. Vendim i DAP per kriteret e rekrutimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore përgatit dhe ruan përshkrimet e punës; bashkëpunon me Rektoren dhe Administratorin për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës së miratuar si dhe ndjek zbatueshmërinë e procedurave të punësimit të personelit deri në firmosjen e kontratës së punës; kjo zyrë ruan të dhënat zyrtare sipas akteve ligjore në fuqi. Mbledhja e të dhënave bëhet mbi bazën e një formulari tip, i cili plotësohet nga personeli efektiv dhe me kontratë. Ruajtja e të dhënave të personelit bëhet me një dosje personale fizike, që përditesohet në bazë të informacionit të paraqitur në Zyrën e Burimeve Njerëzore. GVJ gjatë vizitës kontrollon në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe vërejtje se dokumentacioni i tyre ishte i plotë dhe i përditësuar sipas legjislacionit dhe rregullores të institucionit.</p> <p><i>Aneks 99. Tabela per stafin e angazhuar ne programin e studimit “Bachelor në Administrim Publik”.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Të dhënat e paraqitura në RVB dhe dokumentacionin e përcjellë për këtë program studimi tregojnë se Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në Administrim Publik. Kapacitetet e UAMD-së dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera mundësojnë informacione të përshtatshme në funksion të punimit të temës së diplomës. Departamenti i Administrimit Publik respekton Paketën e Udhëzimeve respektive. Në të paraqiten rregullat e përgjithshme, struktura përkatëse e praktikës dhe temës së diplomës, procedurat dhe afatet kohore të realizimit të tyre, dhe vihet në dispozicion edhe lista konkrete e lektorëve për t’i shërbyer procesit të udhëheqjes.</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë, të pjesshme dhe i ftuar i Departamentit të Administrimit Publik mbështet studentët për realizimin e temave bashkëkohore dhe të dobishme nëpërmjet burimeve që ky personel ka në dispozicion. <i>Sikurse cituar dhe më lart, në kurrikulën e këtij programi mungon praktika profesionale.</i> Në dokumentin “Analiza dhe Raporti vjetor i DAP dhe programit të studimit 2021-2022) mungon realizimi i praktikës mësimore në institucione të ndryshme. <i>GVJ rekomandon përfshirjen e praktikës mësimore në kurrikulën e programit, në mënyrë që studentët të</i></p>

	<p>kryejnë praktikën mësimore pranë institucioneve që UAMD ka marrëveshje dhe përshtatet me profilin e studimit.</p> <p>GVJ, nuk disponon të dhëna të mjaftueshme për të njohur apo evidentuar personelin mbikqyrës në ambientet ku realizohet praktika profesionale e studentëve.</p> <p>Aneks 60, 61. Tabela për programet "Bachelor në Administrim Publik".</p> <p>Aneks 70, 71, 73. Dokumenti Erasmus-Mobility personel akademik dhe studente.</p> <p>Aneks 104. pakete e udhezime e praktike diplomim bachelor 2022.</p>			
Konkluzione	<p>Departamenti i Administrimit Publik garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike kërkimore e përgjithshme dhe specifike e profesorëve, lektorëve, dhe asistent lektorëve të angazhuar në këtë program studimi është në përputhje të plotë me kërkesat e këtij programi sipas natyrës dhe moduleve që ai ka.</p> <p>GVJ rekomandon përfshirjen e Praktikës mësimore në kurrikulën e këtij programi studimi, në mënyrë që studentët të kryejnë praktikën mësimore pranë institucioneve që UAMD ka marrëveshje dhe përshtatet me profilin e studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, ka mjediset mësimore të përshtatshme dhe të mjaftueshme për numrin e studentëve për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse, për të zhvilluar mësimin në të njëjtin orar. Mjediset janë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, ka në funksion për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse ambientet në Kampusin Universitar godina 1 dhe godina 2 si dhe godinën qendrore në Currila.</p> <p>GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe konfirmon se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem</p>

	<p>ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme. Personeli akademik ka një zyrë të veçantë, e cila shërben edhe si zyrë mbledhjesh dhe takimesh. IAL disponon gjithashtu auditorë për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazike mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse në godina të të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre.</p> <p><i>Aneks 65, 66, 67, 68. Infrastruktura tabelat.</i> <i>Vizita në institucion, ambientet e UAMD.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Politike Juridike dhe Departamenti i Administrimit Publik janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike siguron hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar programin e studimit. Mjediset mësimore, auditorët, janë modeste me tabela apo dërrasa dhe ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si videoprojektor dhe PC), përveçse në sallat e laboratoreve.</p> <p>Klasat dhe auditorët janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një proces efektiv të mësimdhënies në përputhje me qëllimet e programit. Gjithashtu në këtë program përdoren metodologjitë teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies sic është sistemi MOODLE, TEAMS, LMS, sistemi që mundësojnë perditësimin dhe ndërveprimin me materialet e lëndës dhe me pedagogun përgjegjës.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Aneks 67. Tabelë për salla, zyra.</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmon se mjediset e vëna në dispozicion përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve siç janë vidioprojektorët, mjetete audiovozove, interneti apo edhe dërrasat e shënimeve, të cilat mundësojnë aftësimin teorik e praktik dhe realizimin e objektivave formues të programit të studimit punonjës social. Për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit janë në dispozicion zyra dhe pajisje kompjuterike të cilat krijojnë kushte normale për realizimin e detyrave për programin e studimit.</p> <p><i>Aneks 43-46 Licensimi dhe Manual i programeve kompjuterike.</i> <i>Aneks 67. Tabelë për salla, zyra.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Natyra e këtij programi studimi nuk kërkon laboratorë të teknologjisë së informacionit për realizimin e objektivave të tij.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi laboratorin e teknologjisë së informacionit, i cili ishte i pajisur me programet profesionale. Laboratori është në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore.</p> <p><i>Aneks 67. Tabela me zyrat e stafit me kohë të plotë dhe të pjesshme.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Departamenti i Administrimit Publik ka mjedise mësimore të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Mjediset janë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3 IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Referuar Aneksve mbi fondin e bibliotekës, konstatohet ajo disponon një fond të lartë librash dhe kopjesh, <i>por nuk evidentohet përshtatja e këtyre tekseve me programin specifik në Administrim Publik. Gjithashtu anëtarësimi në JSTOR dhe U-Library garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe kjo jo në gjuhën shqipe, e cila është gjuhë e detyruar për programin Bachelor. Evidentohet se literatura është kryesisht në anglisht gjë e cila konsiderohet e papërshtatshme për studentët e programit Bachelor. Ka përpjekje për të garantuar literaturë bashkëkohore të dedikuar programit por miratimi i blerjes nuk është realizuar akoma.</i></p> <p>Fondi i librave mund të konsultohet gjithashtu online. Bazuar në kërkesat e personelit akademik fondi është zgjeruar për çdo vit akademik dhe është vendosur në shërbim të studentëve. Kjo mundësohet nga tekste mësimore të përkthyer nga Shtëpitë Botuese, tekste mësimore të shkruar nga stafi pedagogjik dhe tekste mësimore të përkthyer në kuadër të projektit CleanScore të AADF. Sektori i IT mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në Bibliotekën Shkencore në bashkëpunim me Drejtuesin e Bibliotekës. Ai administron dhe kujdeset për funksionimin e mirë të rrjetit të bibliotekës, të dy sistemeve.</p> <p><i>Aneks 26-29 Biblioteka.</i> <i>Aneks 26-29. Rregullorja e Bibliotekës UAMD.</i> <i>Aneks 26. Rregullore e Bibliotekës.</i></p>

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga RVB dhe takimet në Departament evidentohet fakti që Departamenti i Administrimit Publik diskuton dhe miraton programet mësimore të lëndeve dhe moduleve të programit të studimit lidhur me përditësimin e literaturës dhe ndjek botimet e reja nga të gjitha burimet që disponon, sidomos ato që lidhen drejtëpërdrejtë me kurrikulën e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik me synimin për t'i përditësuar msimdhënien dhe mësimnxënien. <i>Ka përpjekje për të garantuar literaturë bashkëkohore të dedikuar programit por miratimi i blerjes nuk është realizuar akoma.</i> <i>Aneks 26-29 Biblioteka.</i> <i>Aneks 26-29. Rregullorja e Bibliotekes UAMD.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për të siguruar akses të plotë për studentët, në nivel Universiteti janë tre ambjente biblioteka, biblioteka e vendosur te godina kryesore dhe te Kampusi universitar, me salla leximi, kompjutera që u mundëson përdoruesve mësimin e programeve të ndryshme, trajnim mbi përdorimin e katalogut online të bibliotekës dhe aktiviteteve të tjera. Studentët e programit të studimit Bachelor në Administrim Publik kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe bibliotekën elektronike. Biblioteka Shkencore e UAMD qarkullon mbi 20.000 njësi bibliotekare në vit, ndërkohë që numri i frekuentuesve është rreth 2000 përdorues në sallën e leximit, ajo është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Salla është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00 - 16:00.</p> <p><i>Aneks 26-29 Biblioteka.</i> <i>Aneks 26-29. Rregullorja e Bibliotekes UAMD.</i> <i>Aneks 26. Rregullore e Bibliotekes.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p><i>Biblioteka e UAMD është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmojë studentet në përgjithësi por nuk evidentohet përshtatja e këtyre teksteve me programin specifik në Administrim Publik.</i> Biblioteka e UAMD ka Katalogun online të integruar për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar të kërkimit të informacionit dhe veç kësaj, ofron falas artikuj shkencorë dhe dizertacione të stafit akademik të UAMD-së Gjithashtu anëtarësimi në JSTOR dhe U-Library garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe kjo jo në gjuhën shqipe, e cila është gjuhë e detyruar për programin Bachelor</p> <p><i>Aneks 26-29 Biblioteka.</i> <i>Aneks 26-29. Rregullorja e Bibliotekes UAMD.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për</p>	<p>Përdorimi i fondit të librave të bibliotekës është i mundur nga të gjithë studentët, stafi akademik dhe kërkues. Me anë të kredencialeve zyrtare ata mund të aksesojnë në çdo moment edhe bibliotekën online.</p>

<p>studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ konfirmoi se UAMD ka anëtarësim të plotë në JSTOR. UAMD është abonuar në libraritë elektronike si EBSCO, biblioteka digjitale që përmbajnë revista akademike që mund të aksesohen lirisht nga studentët dhe stafi akademik. UAMD është gjithashtu pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike on line) një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet erajonit të Europës Juglindore.</p> <p>Si anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Akademike në Shqipëri, përmes projektit ERA2012 (Electronic resources for Albania) lexuesit përfitojnë akses në një gamë të gjerë të burimeve elektronike me tekst të plotë. UAMD fitoi statusin “EU Info Point” me anë të së cilës mbërrijnë në bibliotekën e UAMD periodikisht publikime nga Zyra e Publikimeve të Be-së në Luksemburg. Biblioteka e UAMD është pjesë e ALASE (Albanian Academic Research Engine). Çdo anëtar i personelit akademik dhe student ka akses në koleksionet e U-Library dhe mund të aksesojnë disa artikuj në mënyrë periodike.</p> <p><i>Aneks 26-29 Biblioteka.</i> <i>Aneks 26-29. Rregullorja e Bibliotekës UAMD.</i> <i>Aneks 26. Rregullore e Bibliotekës.</i> <i>Aneks 29.2 Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik Jstore.</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UAMD është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Koleksioni përpunohet nga ana shkencore bibliografike konform standarteve ndërkombëtare duke përdorur UDC (sistemi i klasifikimit), ISBD (International Standard Bibliographic Description), formatin MARC, Z39.50 SRU. Për të aksesuar shërbimin e librarisë digjitale, fillimisht aksesohet në linkun: https://ulibrary.rash.al/ dhe Faqja kryesore e shërbimit përmban krahas një videoje informuese dhe hapat kryesore që duhet të ndiqen.</p> <p><i>Aneks 29.2 Marrëveshjet e bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik Jstore.</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Salla është në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00 - 16:00. Shërbimi i informacionit elektronik mbetet i hapur nga e Hëna në të Diel 08:00-20:00.</p> <p>Nga personeli i bibliotekës u konfirmua se studentët e frekuentonin bibliotekën kryesisht gjatë periudhave të provimeve, në pushimet midis orëve ose kur punonin për kryerjen e detyrave në grup dhe duhet të rishikonin literaturë.</p> <p><i>Aneks 26. Rregullore e Bibliotekës.</i></p>

<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Çdo vit, sipas kërkesave të stafit akademik përgatitet lista e blerjeve për të pasuruar fondin e Bibliotekës. Kërkesat evidentohen në Departament të cilët në fillim të vitit akademik diskutojnë programet e lendëve, ndryshimet, përmirësimet dhe përcaktojnë kërkesën për literaturën. <i>Nga takimi me stafin u konfirmua fakti që institucioni i merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë plotësuese por për këtë vit akoma nuk ishte miratuar lista e librave të kërkuar nga departamenti. Nuk gjenden raporte analitike mbi efektshmërinë e investimeve në pasurimin e fondit fizik dhe atij online.</i> Aneks 26. Rregullore e Bibliotekës.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka krijuar kushtet për të mbështetur programin e studimit me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e tij. Biblioteka ka mjediset e përshtatshme por nuk disponon fondin e nevojshëm të titujve. Referuar Aneksve mbi fondin e bibliotekës, konstatohet ajo disponon një fond të lartë librash dhe kopjesh, por nuk evidentohet përshtatja e këtyre tekseve me programin specifik në Administrim Publik. Gjithashtu anëtarësimi në JSTOR dhe U-Library garanton akses në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe kjo jo në gjuhën shqipe, e cila është gjuhë e detyruar për programin Bachelor. Evidentohet se literatura është kryesisht në anglisht gjë e cila konsiderohet e papërshtatshme për studentët e programit Bachelor. Ka përpjekje për të garantuar literaturë bashkëkohore të dedikuar programit por miratimi i blerjes nuk është realizuar akoma. GVJ gjykon se shtimi i fondeve përmes blerjeve është një praktikë e cila duhet marrë vëmendje, të analizohet dhe të ndërtohen plane konkrete veçanërisht për fondin fizik të librit shqip dhe dorëzimin e leksioneve të pedagogëve pasi kështu mund të mundësohet pasurimi i fondeve dhe përditësimi i literaturës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të</p>	<p>UAMD përmban informacion personal të studentit dhe adresat e tyre elektronike. Studentët gjithashtu, informohen nga faqja zyrtare e</p>

<p>cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UAMD, www.uamd.edu.al, rrjetet sociale, në ambjentet brenda godinës si dhe nga sistemi Pitagora. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka në ëeb site zonën e studentit e cila informon studentët me të gjitha njoftimet, si edhe përmban informacion në lidhje me: manifesti i studentit, shkëmbime dhe praktika, orari, lidhshipi studentor, zyra e komunikimit Alumnit dhe karrierës, bursa dhe tarifa. Përmes sistemit të integruar "Pitagora" parashikohet realizimi i komunikimit midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit.</p> <p><i>Aneksi 51. Buletini i aktiviteteve per FSHPJ.</i></p> <p><i>Aneksi 60, 61. Programi "Bachelor në Administrim Publik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Burimet njerëzore dhe Departamenti i Administrimit Publik administrojnë dokumentacionin përkatës për partnerët dhe për stafin e angazhuar në këtë program studimi. Sistemi i UAMD-së për ruajtjen e informacionit të personelit bazohet në arkivimin e dokumentacionit në formën hardcopy dhe elektronike dhe kjo ka rezultuar efektive. Departamenti dhe Zyra e Burimeve Njerëzore ruan CV-të, ngarkesat dhe dokumenta të tjera të nevojshme që lidhen me veprimtarinë e personelit.</p> <p>Sistemi i bazuar në letër i menaxhimit të dokumentacionit të nevojshëm që përdoret në UAMD mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentët sipas programeve të studimit. Për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për programin Bachelor në Administrim Publik, personelit dhe studentëve u garantohet aksesin në mënyrë fizike dhe nëpërmjet ëeb mail ku është zona e studentit dhe ajo e pedagogut. Për realizimin e programit Bachelor në Administrim Publik sistemi i brendshëm i menaxhimit është efikas.</p> <p><i>Aneksi 99. Tabela per stafin e angazhuar ne programin e studimit "Bachelor në Administrim Publik.</i></p> <p><i>Aneksi 51. Buletini i aktiviteteve per FSHPJ.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Shkëmbimi i informacionit midis stafit dhe studentëve bëhet përmes e - maileve të stafit që vihen në dispozicion të studentëve nga fillimi i vitit akademik. Përmes sistemit të integruar "Pitagora" parashikohet realizimi i komunikimit midis studentëve dhe stafit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve dhe informacionit.</p> <p><i>Aneksi 44. Manual PITAGORA.</i></p> <p><i>Aneksi 3,4. Rregullore e UAMD Neni 64, pika 3, pika 4, pika5.</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Monitorimi i aktivitetit akademik e administrative bëhet nga njësisia bazë – Departamenti i Administrimit Publik që raporton te zv Dekani për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky informacion shërben edhe për organet drejtuese dhe titullarët për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p><i>Aneksi 3,4. Rregullore e UAMD.</i></p>

<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, www.uamd.edu.al paraqet në mënyrë të strukturuar informacione mbi universitetin, pranimet, fakultetet, programet e studimit, për studentët, projektet dhe shërbimet për studentë të publikuara në 2 (dy) gjuhë, shqip dhe anglisht. Gjatë vizitës GVJ konstatoi që departamenti nuk ka një politikë të standardizuar apo manual për publikimin, por kryesisht të gjitha aktivitetet publikohen në faqen eeb të institucionit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Monitorimi i aktivitetit akademik e administrativ për mbarëvajtjen e procesit mësimor bëhet nga njësia bazë dhe ky informacion shërben edhe për organet drejtuese dhe titullarët për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit akademik dhe realizimin e programit mësimor. UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Buxhetimi financiar në nivel institucioni bëhet çdo vit. Raportet financiare hartohen në bazë institucioni dhe janë të ndara sipas cikleve dhe programeve të studimit. Planifikimi i financimit realizohet në mënyrë paraprake për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit <i>Aneksi 89. Tabela e kostove për programin e studimit Bachelor ne AP.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe përmban të gjithë elementët financiarë në bazë programi. Plani i financimit të programit të studimit përmban të gjitha elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: orë mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, shpenzimet e ndryshme operative etj., si dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe çdo zë tjetër të nevojshëm. <i>Aneksi 89. Tabela e kostove për programin e studimit Bachelor ne AP. Aneksi 39. Raport per veprimtarine financiare 2020-2021.</i></p>

shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Njësia e Auditimit të Brendshëm ka për detyrë realizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me planet e miratuara, UAMD kryen auditim të veprimtarisë nga njësitë e auditimit të brendshëm. Institucioni ka raporte auditimi të brendshëm çdo vit. Auditimi financiar dhe raportimi financiar janë procedura të përvitshme të dokumentuara që dëshmojnë efektivitetin financiar të UAMD. <i>Aneksi 39. Raport per veprimtarine financiare 2020-2021.</i> <i>Aneksi 117. Raporti i veprimtarise audituese.</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Plani i financimit hartohet në nivel institucioni dhe përmban elementët financiarë për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programit të studimit. Institucioni raporton në mënyrë periodike për realizimin e buxhetit, për rishikimin dhe për rialokimin e buxhetit, sipas ligjit mbi buxhetin. Institucioni harton Raport Financiar, si pjesë e raportit vjetor dhe buxhetit të miratuar UAMD raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik. <i>Aneksi 89. Tabela e kostove për programin e studimit Bachelor AP.</i> <i>Aneksi 39. Raport per veprimtarine financiare 2020-2021.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti “Aleksandër Moisiu” është një universitet publik dhe si i tillë, ashtu si dhe demonstron në planbuxhetet e paraqitura, të dhënat financiare dëshmojnë se ai siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për gjenerimin e të ardhurave gjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe për të ardhmen. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare UAMD planifikon ndërhyrje të posaçme por duhet të punojë më shumë për diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. <i>Aneks 53,54. Të dhënat financiare për mbështetjen e programit të studimit Bachelor AP.</i> <i>Aneks 39. Raporti i Veprimtarise Ekonomiko Financiare 2020-2021.</i>
Konkluzione	<i>Plani i financimit dhe buxhetimi financiar dhe auditimi hartohen në nivel institucional dhe përmbajnë të gjithë elementët financiarë në bazë programi. UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i> <i>Për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve të programit, GVJ rekomandon që njësia bazë të aftësohet në proceset e financimit, shpenzimeve, detyrimeve financiare apo dhe kontratave të</i>

	<i>shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit, për të garantuar edhe në këtë drejtim autonominë e njësisë bazë, sipas frymës së ligjit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për vlerësimin e këtij kriteri, grupi i vlerësimit të jashtëm u bazua në nenin 57, pika 4; nenin 64; nenin 76 të Statutit të Ri UAMD, në nenin 26, pika 1, 3, 4; nenin 27 të Statutit të Vjetër UAMD, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Administrim Publik” dhe vëren se në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës procesi që nga hyrja deri në daljen e studentëve në të gjithë ciklin e studimit, mbështetet në politika dhe procedura të cilat janë në respektim të plotë të legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore të institucionit. <i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Aneks 2. Statuti i vjetër UAMD.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i Statutit dhe Rregullores së institucionit GVJ konstatoi se politikat dhe procedurat që ndjek UAMD nga hyrja në daljen e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Respektohen detyrimet ligjore mbi regjistrimin, dhe ngrihet një komision <i>ad hoc</i> , i cili pas shqyrtimit të listës së aplikantëve shpall dhe listën e kandidatëve fitues për programin e studimit. Bazuar në Statutin e Ri UAMD Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike; Rregulloren e Programit të Studimit bachelor në “Administrim Publik”, vihet re se barazia dhe të drejtat e njëjta në hyrje dhe në dalje për të gjithë kandidatët janë vlera të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës si edhe të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike si një ndër njësitë e tij. Ato garantojnë nëpërmjet politikave dhe procedurave që nga seleksionimi, rekrutimi, trajnimi dhe formimi

	<p>i kandidatëve për studentë, e studentëve të programit të studimit në të gjithë ciklin e studimit.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 2. Statuti i vjetër UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Institucioni bashkëpunon me QSHA-në në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. GVJ konfirmon sipas vendimit të Senatit për Kriteret e Pranimiit të Studentëve për studentë për ciklin e parë të studimeve. Kriteret e veçanta që duhen përmbushur nga ana e kandidatëve hartohen dhe bëhen publike si nga ana e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakultetit të Shkencave Politike Juridike dhe nga Departamenti i Administrimit publik në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Gjithashtu edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës informon mbi kriteret e pranimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin.</p> <p><i>Aneks 96. Vendim Senati për Kriteret e Pranimiit të Studenteve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konfirmon që kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve janë në përputhje me VKM në fuqi dhe ka edhe një Vendim senati për kuotat. Edhe procedurat për përparimin e studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e institucionit. Aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me programin e studimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike si një ndër Njësitë e tij, bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit dhe mjeteve të komunikimit për kandidatët për student, studentët dhe të gjithë të interesuarit gjatë të gjithë ciklit akademik.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 2. Statuti i vjetër UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në IAL konfirmoi organizimin e ditëve të informimit për maturantët e shkollave të mesme, kryesisht të rajonit dhe konform një plani. Gjithashtu maturantët ftohën në kampus dhe marrin informacion të detajuar për fakultetin dhe për programe specifike të studimit. Ata informohen gjithashtu për kriteret e pranimit dhe kërkesat për t'u regjistruar. Maturantëve iu jepet mundësia të takohen dhe me stafin akademik të programit të studimit për të cilin kanë interes. Në mbështetje të Programit të Transparencës së UAMD, njoftime nga faqja eeb UAMD: https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimiit/, kandidatët për studentë, të gjithë të interesuarit dhe publiku i gjerë udhëzohen përpara</p>

	fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e veçanta dhe të përgjithshme për pranimin në programin përkatës të studimit si nga ana e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakultetit të Shkencave Politike Juridike dhe Departamenti i Administrimit Publik. <i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD.</i>			
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se bazuar në Rregulloren për Studentët me Aftësi të kufizuar, Departamenti i Administrimit Publik çdo vit akademik përcakton, harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi veçanta që aplikojnë për program studimi, transferim studimesh, studentët me aftësi të kufizuar, komuniteti rom dhe ai ballkano egjiptian, studentët me statusin e jetimit, për shtresa në nevojë, si dhe studentë të ardhur nga trojet, për vitin akademik pasardhës. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i përcillen Senatit Akademik, i cili mer vendimin përkatës dhe publikohen në faqen zyrtare të UAMD: https://uamd.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024 . Për sa i përket kuotave, ato i përcillen Bordit të Administrimit për miratim. Pas përfundimit të procedurës nga IAL-ja, kriteret dhe kuotat i përcillen MAS në afatet e përcaktuara. <i>Aneks 20. Rregullore për Studentët me Aftësi të kufizuar.</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Sipas Vendimit të Senatit për Kriteret e Pranimit të Studentëve Departamenti i Administrimit Publik përcakton, harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për përzgjedhjen e kandidatëve me shtetësi të huaj për vitin akademik pasardhës. Kriteret pasi shqyrtohen në dekanat, i përcillen Senatit Akademik, i cili mer vendim. <i>Aneks 96. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve.</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UAMD ka të miratuar Rregulloren për Studentët me Aftësi të kufizuar, si edhe Urdhër për trajtimin me bursë të studentëve nga shtresat në nevojë, të cilëve iu mundësohet trajtim i diferencuar. Kriteret dhe informacioni për përfitimet publikohen nga në faqen zyrtare dhe iu komunikohen nga strukturat e UAMD të interesuarve edhe me kanale të tjera komunikimi dhe me komunikim të drejtpërdrejtë. Studentët plotësojnë formularë aplikimi për trajtimin me bursë. <i>Aneks 20. Rregullore për Studentët me Aftësi të kufizuar.</i> <i>Aneks 128. Urdhër për trajtimin me bursë të studentëve nga shtresat në nevojë.</i> <i>Aneks 129. Formularë Aplikimi për Trajtimin me Bursë.</i>			
Konkluzione	UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Re të UAMD, Rregulloren e Vjetër të UAMD Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Administim Publik”, kalimi nga një vit akademik në tjetrin dhe progresi akademik i studentëve në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës mundësohet nëpërmjet ofrimit të një informacioni të plotë dhe transparent nga ana e Departamentit të Administrimit Publik. GVJ konfirmoi se studentët ishin të informuar mbi detyrimet e përgjithshme të programit të studimit si dhe për detyrimet specifike për çdo lëndë nga pedagogu përgjegjës.</p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim public.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët e programit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Re UAMD (neni 54; neni 56); Rregulloren e Vjetër UAMD (neni 55 pika 2, shkronja d; neni 73, neni 74, neni 76), Rregulloren e FSHPJ, Rregulloren e DAP, Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik dhe në Programin e Transparencës UAMD, kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme, të plota ose të pjesshme janë të përcaktuara nga UAMD dhe të kuptueshme e të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe për të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Aneks 4. Rregullore e vjetër UAMD.</i> <i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i> <i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, informacioni në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të aftësive dhe dijeve u vihet në dispozicion studentëve ana e Departamentit të Administrimit Publik si dhe gjatë shpërndarjes dhe shpjegimit të syllabuseve nga ana e lektorëve të lëndëve respektive që në orën e parë mësimore të semestrit. GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit, përfshirë kriteret dhe procedurat për vlerësimin e njohurive dhe aftësive.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Aneks 4. Rregullore e vjetër UAMD.</i></p>

	<p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i> <i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Re UAMD (nenet 75-78), Rregulloren e Vjetër UAMD (nenet 56-60), rregulloren e FSHPJ, rregulloren e programit të studimit MSHAP, procedurën e diplomimeve në Departamentin e Administrimit Publik, të gjitha etapat që lidhen me kriteret dhe procedurat e diplomimit të programit të studimit janë të përcaktuara, të kuptueshme dhe të aksesueshme nga studentët duke vënë në dispozicion strukturat përkatëse përgjegjëse dhe kanale e mjete të ndryshme komunikimi.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Aneks 4. Rregullore e vjeter UAMD.</i> <i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i> <i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit bachelor administrim publik.</i> <i>Aneks 104. Pakete e udhezime e diplomim bachelor 2022.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Administrimit Publik angazhohet në fillim të çdo viti për tërheqjen e kandidatëve potencialë për student duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura ku i shpalosen informacione në lidhje me programin e studimit, mundësitë e punësimit si edhe aftësimin e vazhdueshëm të studentëve duke qenë të hapur ndaj feedback, diskutimeve apo sugjerimeve të mundshme. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Departamentit të Administrimit Publik në panaiet promovuese të programit të studimit u lejon të kontaktojnë personalisht me maturantët e interesuar duke iu sqaruar avantazhet e regjistrimit në atë program studimi.</p> <p><i>Aneks 135. Vendimi i mentorimeve dhe grafiku.</i> <i>Të dhëna nga faqja zyrtare ëeb UAMD:</i> https://uamd.edu.al/dokumentacioni-per-te-aplikuar/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>UAMD dhe Departamenti i Administrimit Publik në fillim të çdo viti akademik, organizon një takim informues dhe orientues me studentët ku prezantohen të gjitha elementet e programit të studimit, plani mësimor, kohëzgjatja e programit, struktura e institucionit etj. Ndërsa në fillim të çdo viti akademik të tre vitet e studimit informohen hollësisht mbi detyrimet akademike dhe periudhën e provimeve. Ndërsa informacioni mbi organigramën e Fakultetit, strukturën e departamentit dhe veprimtarinë e tij, detaje mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen e institucionit. GVJ konfirmoi sa më sipër gjatë takimit me stafin dhe me studentët.</p> <p><i>Aneks 143. Urdher per promovimin e programeve te studimit UAMD Eork & Study Fair.</i></p> <p><i>Aneks 136. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Bazuar në të dhënat nga Programi i Transparencës së UAMD, Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Administrim publik”, e përditësuar dhe e publikuar në faqen zyrtare ëeb, Departamenti i Administrimit Publik nëpërmjet Javës së Orientimit dhe Guidës së Studentit i orienton studentët në mënyrë të vazhdueshme. Studentët kanë akses të plotë dhe transparent mbi dokumentacionin/udhëzuesit e lëndëve/moduleve, përmbajtjen e tyre si dhe aktivitetet formuese të ndërlidhura me to. Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua që studentët njihen që ditën e parë me rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit te studimit bachelor administrim publik.</i></p> <p><i>Aneks 136. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>UAMD dhe konkretisht Zyra e Këshillimit dhe Karrierës si strukturë përgjegjëse e institucionit bazuar në Rregulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, Raporti i Sektorit të Karrierës dhe Alumnit orienton dhe këshillon studentët për mundësitë e praktikave mësimore, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe mundësive të punësimit. <i>Nga takimi që GVJ pati me studentët ata nuk kishin informacione mbi studimet e tregut të punës, si dhe nuk ishin orientuar drejt mundësive të punësimit dhe tregut të punës.</i> Kjo mund të jetë edhe për shkakun se pritet që ata të përfundojnë ciklin e dytë të studimeve para se t’i drejtohen tregut të punës.</p>

	<p><i>Aneks 21. Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres</i> <i>Aneks 22. Raport Sektori i Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Të dhëna nga faqja zyrtare ëeb UAMD: https://uamd.edu.al/</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>UAMD publikon të dhënat në faqen zyrtare web https://uamd.edu.al/ për Strategjinë e Komunikimit informacion i cili është lehtësisht i aksesueshëm dhe i plotësuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet strukturave dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit. Orari mësimor afishohet në faqen e internetit dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën lidhur me mjediset që do përdoren, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Gjatë takimeve dhe seancave orientuese studentët marrin gjithashtu informacion mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që u ofrohen për të realizuar studimet e tyre. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konfirmon se informacioni që ju vihej në dispozicion ishte i plotë e shterues.</p> <p><i>Aneks 14. Strategjia e Komunikimit – UAMD.</i> <i>Aneks 66. Përmbledhëse kapaciteti UAMD.</i> <i>Aneks 67. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Administrim Publik”, studentit i ofrohet informacion i përditësuar nga faqja zyrtare ë=web: https://uamd.edu.al/departamenti-i-administrimit-publik/, si dhe përdoren edhe platforma të tjera bashkëkohore për të shpërndarë informacion lehtësisht të aksesueshëm dhe të detajuar lidhur me programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme e të përditësuar edhe në distancë.</p> <p><i>Aneks 21. Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.</i> <i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD.</i> <i>Të dhëna nga faqja zyrtare web: https://uamd.edu.al/departamenti-i-administrimit-publik/</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>UAMD vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. GVJ konfirmon se studentët ishin të informuar mbi objektivat formuese të secilës lëndë, si dhe kishin informacion të plotë e të hollësishëm për programin e studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Të dhënat në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar e diplomuar përfshihen tek analiza vjetore e institucionit si edhe statistikat përfshihen tek vlerësimi i brendshëm i cilësisë.</p> <p>GVJ vizitoi Sekretarinë mësimore ku mbahen regjistrat në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike dhe diplomimin e studentëve. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është më i ulët sesa kuotat e miratuara. Sipas drejtuesve të njësisë bazë dhe njësisë kryesore në këtë trend ka ndikuar situata e përgjishme e numrit të studentëve në vend, kryesisht emigracioni.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Neni 92, Neni 93.</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Neni 89</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ, Neni 75.</i></p> <p><i>Aneks 37. Raport Vjetor UAMD 2021-2022.</i></p> <p><i>Aneks 88. tabela e numrit te studenteve per FSHPJ 2019-2023.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga kontaktet me sekretarinë u vu re se Sekretaritetë Mësimore, të cilat janë të ndara sipas fakulteteve, organizojnë punën brenda afateve të paracaktuara për të realizuar regjistrimet e studentëve fitues të programeve të ciklit të parë të studimit sipas listave të paraqitura nga komisionet ad-hoc, të përcjella/miratuara nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore si dhe dokumentacionit të përcaktuar në udhëzimet përkatëse të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Sekretaria mësimore hedh të dhënat e studentëve të regjistruar në formatin e miratuar, të cilat pasi konfirmohen nga Kryesekretaria i dërgohen institucionit përkatës për matrikullim.</p> <p>Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar, etj, duke u bazuar në procedurat e përcaktuara në rregulloren e UAMD. Statistikat e përgatitura ruhen në hard dhe soft copy. Të dhënat statistikore dërgohen brenda afateve të përcaktuara pranë drejtorisë së Statistikavë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. UAMD disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë sipas kriteve të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Këto të dhëna u verifikuan edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Aneks 88. tabela e numrit te studenteve per FSHPJ 2019-2023.</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UAMD, të dhënat për studentët janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat ruhen konform akteve rregullatore të Universitetit. Të dhënat statistikore të studentëve përgatiten dhe ruhen elektronikisht si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare, kryesekretaret në bashkëpunim me sekretaret</p>

	<p>mësimore kryejnë pasqyrimin e notave në bazën elektronike të të dhënave konform manualit për funksionimin e sekretarisë.</p> <p><i>Aneks 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Aneks 132. Raporti Vjetor FSHPJ v.a.2021-2022.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>UAMD ka hartuar manualin për funksionimin e sekretarisë mësimore ku shpjegon qartë jo vetëm saktësinë për ruajtjen e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, por edhe mënyrën e kryerjes në mënyrë periodike të kontrolleve për vlerësimin e të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin, përfshirë sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit etj.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Të gjithë përdoruesit kishin akses të personalizuar sipas roleve të tyre dhe njësive përkatëse në sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve.</p> <p>GVJ bëri verifikime të të dhënave të studentëve të regjistruar e të transferuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi. Sekretaritë mësimore hartojnë raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</p> <p><i>Aneks 74. Manual per funksionimin e sekretarisë.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti i Administrimit Publik, bazuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Rregulloren e vetë departamentit, si edhe rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Administrim Publik", për çdo vit akademik harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve të cilat evidentohen në analiza dhe raportin vjetor të DAP. Analiza mësimore vjetore në nivel departamenti i përcillet Fakultetit me qëllim në përfshirjen në analizën vjetore të njësisë kryesore.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i> <i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 21. Rregullore e Sektorit te Komunikimit, Alumnit dhe Karrieres.</i> <i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i> <i>Aneks 95. Analiza dhe Raporti vjetor i DAP dhe programit te studimit 2021-2022.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>UAMD mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Kjo është një praktikë e mirë që promovon demokracinë dhe transparencën në proceset vendimmarrëse të institucionit.</p> <p>Rregullorja e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, përcakton përfaqësimin e studentëve në organet e UAMD, marrjen pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së Universitetit, ku këshillat e studentëve kanë të drejtë të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e UAMD-së dhe njësisë kryesore si edhe të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimeve të UAMD-së, rregulloret dhe veprimtaritë mësimore.</p> <p>Përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe zhvillimit të institucionit. Kjo promovon ndjenjën e përgjegjësisë dhe ndjenjën e pronësisë së përbashkët ndër studentët, si dhe rrit transparencën dhe llogaridhënien në proceset vendimmarrëse të institucionit.</p> <p>Aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përcaktojnë procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e tyre në organet vendimmarrëse. Këto akte gjithashtu përcaktojnë mënyrat e komunikimit dhe bashkëpunimit midis përfaqësuesve të studentëve dhe organet vendimmarrëse të institucionit.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi që IAL është angazhuar maksimalisht në orientimin e studentëve në lidhje me të drejtat e tyre dhe përfaqësimin e tyre në hallkat e institucionit, për të sjellë shqetësimet dhe zgjidhjet e tyre. Gjatë vizitës GVJ konfirmoi se përfshirja e studentëve mundësohej nëpërmjet pyetësorëve që plotësojnë për vlerësimin e procesit akademik, i cili është një proces që kryhet në mënyrë të pavarur nga secili pedagog në fund të semestrit. Studenti ka të drejtë të japë vlerësimin e vetë në mënyrë të pavarur dhe pa praninë e pedagogut të lëndës në auditor në momentin e vlerësimit. Në përfundim të procesit të vlerësimit Njësia e Sigurimit të Cilësisë bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr rezultatet e përfuara nga vlerësimi që diskutohet në Analizën dhe Raportin vjetor të DAP dhe programit të studimit.</p>

	<p><i>Aneks 31. Rregullore e programit te studimit bachelor administrim publik.</i></p> <p><i>Aneks 87. Anketa Studente Bachelor Administrim Publik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve dhe duke zbatuar aktet ligjore në fuqi.</p> <p>Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FSHPJ, Rregullorja e DAP si edhe Rregullorja e Programit të Studimit parashikojnë përfshirjen e studentëve në struktura të rëndësishme të vendimmarrjes me qëllim dhënien e kontributit të tyre në rritjen e cilësisë së vazhdueshme të programeve të studimit. Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to.</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore DAP.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregullorja mbi studimet universitare dhe provimet, si dhe udhëzimi mbi provimet mundëson barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit, rishikimit dhe përmirësimit të rezultateve të provimit studentëve si dhe përcakton përcaktimit e procedurës që duhet të ndiqet nga institucioni në çdo rast.</p> <p>GVJ konstatoi se ky informacion ju bëhej me dije studentëve dhe u konfirmua po ashtu edhe gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se kjo e drejtë e tyre ishte plotësuar në rast nevojë.</p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i></p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e Re e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i></p> <p><i>Aneks 81. Pyetësor Student UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti i Ri i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me studentët.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimarrëse e këshilluese është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit dhe zhvillimit të institucionit. Por në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit nuk ka të dhëna se si garantohet përfshirja e</i></p>

	<i>studentëve dhe nuk ka një praktikë që të reflektojë sugjerimet e kontributin e studentëve në to.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UAMD ka krijuar strukturën e vet, e cila u siguron studentëve mbështetjen e nevojshme akademike, vën në dispozicion burimet dhe plotëson kërkesat që iu duhen për të pasur sukses në universitet (Sekretaritet, Zyra e IT, Zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI). Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. <i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD.</i> <i>Aneks 136. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ka krijuar struktura të posaçme dhe funksionale në shërbim të studentëve, por ka në dispozicion edhe një sistem menaxhimi i cili është në dispozicion të çdo studenti. Në javën e parë të çdo viti akademik departamentet organizojnë informimin e studentëve të vitit të parë mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit. Gjatë takimit me studentët GVJ konfirmoi asistimin e tyre përgjatë procesit mësimor me të gjithë çështjet që lidhen me programin e studimit. <i>Aneks 135. Vendim i mentorimeve dhe grafiku</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga vizita në institucion dhe takimi me përfaqësues të Sektorit të Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, GVJ u informua bazuar në Regulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumni & Karrierës, si edhe Raportëve vjetore, sektori i Karrierës dhe Alumni është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron shërbime të ndryshme këshillimi dhe konsultimi për studentët e rinj dhe për ata që diplomohen. Roli i saj konsiston në informimin e studentëve mbi mundësi për aktivizimin e potencialeve të tyre, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore. Gjithashtu në këtë kuadër ky sektor, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe

	<p>raporton periodikisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat statistikore. <i>Por studentët nuk e njihnin mirë rolin e plotë të zyrës.</i></p> <p><i>Aneks 18. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrieres</i> <i>Aneks 22. Raport Sektori i Karrierës dhe Alumnit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me Sektorin e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe studentët.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>UAMD ka hartuar dhe vënë në zbatim Regulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumnit & Karrierës. Ky sektor ofron jo vetëm vendosjen e kontakteve me Alumnit e UAMD me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t' i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash, por edhe ftesën për Alumnit e suksesshëm për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme;</p> <p>Ish studentët (alumni), që kanë arritur një nivel të lartë profesional, propozohen për “Çmimin e Karrierës”, i cili synon të promovojë arritjet e tyre dhe të shërbejë si shembull për të gjithë ata që do të mbarojnë studimet pranë UAMD sic evidentohet në Raportin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit. <i>GVJ konfirmon që zyra nuk ka mundur të zhvillojë çdo vit vrojtimin me studentët e diplomuar, pasi stafi në dispozicion nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk mund të realizohej një gjurmim i tillë për të gjithë programet.</i></p> <p><i>Aneks 18. Regullore Sekt. i Komunikimit, Alumnit & Karrieres.</i> <i>Aneks 22. Raport Sektori i Karrierës dhe Alumnit.</i> <i>Aneks 22.2 Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>UAMD ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron promovimin e zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit në të gjithë universitetin dhe zgjerim të stafit të zyrës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton se Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka krijuar struktura dhe ka miratuar politika të brendshme që sigurojnë cilësinë në mësimdhënie në përmbushje të kërkesave të ligjit, të cilat kanë objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme në mbështetje të Rregullores së NJBSC.</p> <p><i>Aneks 4. Rregullore e vjeter UAMD, neni 68, “Kontrolli i Cilësisë së Mësimdhënies”.</i></p> <p><i>Aneks 122 Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ konstaton ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe të praktikave profesionale, procesin e kontrollit të dijeve, diplomimit, si dhe të veprimtarive administrative dhe financiare të Univesitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Për të vlerësuar dhe monitoruar aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmë s akademik, struktura përgjegjëse zhvillon mekanizma të ndryshëm. Këto mekanizma përfshijnë vlerësimin periodik të punës së tyre, si dhe monitorimin e performancës së tyre gjatë kohës. Një mënyrë e zakonshme për të vlerësuar aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik është përmes vlerësimit të mësimdhënies së tyre nga studentët. Kjo bëhet përmes sondazheve të plotësuar nga studentët që organizohet nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, ku ata japin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe aftësitë e pedagogëve. Këto vlerësime janë anonime për të siguruar transparencën dhe sinqeritetin e tyre. Jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i semestrit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i paraqet Rektoratit raportin e vlerësimit semestral. Përveç vlerësimit nga studentët, strukturat përgjegjëse organizojnë edhe vlerësime të tjera, si p.sh. vlerësimi i mësimdhënies në auditor nga Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Këto vlerësime përfshijnë vlerësimin e aftësive mësimdhënëse, inovacionit në mësimdhënie, kontributit në zhvillimin e kurrikulave dhe shumë të tjera. Për të monitoruar performancën e personelit akademik dhe ndihmë sakademik në mënyrë periodike, strukturat përgjegjëse organizojnë takime të rregullta për të diskutuar përparimin e tyre në mësimdhënie dhe inovacion. Këto takime janë individuale ose grupore, dhe përfshijnë diskutime mbi sfidat dhe arritjet e tyre në mësimdhënie, si dhe planifikimin e hapat e ardhshëm për të përmirësuar aftësitë e tyre. Përmes këtyre mekanizmave të monitorimit</p>

	<p>dhe vlerësimit periodik, strukturat përgjegjëse sigurojnë që personeli akademik dhe ndihmës akademik mban një standard të lartë të aftësive mësimdhënëse dhe inovative, dhe është në gjendje të përmirësoje performancën në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>Aneks 4. Rregullore e vjeter UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 122 Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Aneks 82. Raporti i rezultateve te anketimit te Studenteve, Stafit Akademik dhe administrates mbi institucionin.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ u informua nëpërmjet takimeve me pedagogët dhe studentët se UAMD për të garantuar përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe trajtimit të ankimimeve ka ndërmarrë disa masa.</p> <p>UAMD ka vendosur një proces të qartë dhe të lehtë për studentët për të paraqitur ankesa në lidhje me çështje të ndryshme, duke përfshirë mësimdhënien, vlerësimin dhe trajtimin e tyre, të paraqiten pranë Përgjegjësit të departamentit, Dekanit dhe autoriteteve të tjera drejtuese.</p> <p>Sigurimin e transparencës në procesin e vlerësimit të dijeve. Institucioni ofron informacion të detajuar për kriteret e vlerësimit dhe metodat e përdorura, duke i lejuar studentët të kenë një kuptim të qartë të procesit dhe të kenë mundësi të paraqesin ankesa me shkrim përgjegjësit të departamentit nëse kanë dyshime mbi vlerësimin e tyre. Përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të politikave të institucionit në lidhje me mësimdhënien, organizon një anketim të përvitshëm për të matur vlerësimin e studentëve për performancën e lektorëve. Këto masa kanë për qëllim të sigurojnë përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit dhe të trajtimit të ankimimeve, duke i dhënë atyre mundësinë të japin kontributin e tyre dhe të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit.</p> <p><i>Aneks 79. Praktike e formularit të vetevlerësimit te personelit akademik.</i></p> <p><i>Aneks 114. CV DAP.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me pedagogët e DAP, si dhe pas shqyrtimit të Aneksit 82, konstaton se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të kryer për çdo semestër akademik, të cilat i vihen në dispozicion strukturave vendimmarrëse të fakultetit, si dhe në mënyrë individuale të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar.</p> <p><i>Aneks 82. Raporti i rezultateve te anketimit te Studenteve, Stafit Akademik dhe administrates mbi institucionin.</i></p> <p><i>Aneks 79. praktike e formularit të vetevlerësimit te personelit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira,</p>	<p>Gjatë takimit me pedagogët e DAP, GVJ konstatoi se krahas procedurave të akreditimit për të siguruar cilësinë e programve UAMD vlerëson edhe performancën e programeve të studimit mbështetur në treguesit e cilësisë për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, rishikon</p>

nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	dhe përmirëson ato duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës, opinionet e marra nga studentët dhe alumni, vlerëson mësimdhënien dhe rezultatet e të nxënit. <i>Aneks 4. Rregullore UAMD, neni 52, "Ankimi për rezultatin përfundimtar".</i> <i>Aneks 82. Raporti i rezultateve të anketimit të Studenteve, Stafit Akademik dhe administratës mbi institucionin.</i> <i>Aneks 25 Rregullore për sigurimin e cilësisë e rishikuar.</i>			
Konkluzione	GVJ, mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar dhe takimet e realizuara me Drejtuesin e DAP, pedagogët, studentët, konstaton se UAMD ka të përcaktuar një politikë të qartë në nivel institucional dhe në nivel të fakulteteve për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe është në fazën e përfundimit të udhëzuesve të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit, në mënyrë që dhe komisionet në nivel fakulteti të nisin procesin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, GVJ konstaton se UAMD, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, ka organizuar dhe ka miratuar mënyrën e funksionimit të Drejtorisë së Kurrikulave & Standardeve të Cilësisë, e cila ndër përgjegjësitë e tjera ka dhe menaxhimin e procesit të matjes së performancës, nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve institucionalë. Gjithashtu parashikimet ligjore mandatojnë Departamentin si njësi përgjegjëse për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit kryhet nga departamentet përkatëse. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike ka në përbërje të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nga një përfaqësues për secilin departament, ku Departamenti i Administrimit Publik ka propozuar gjithashtu një përfaqësues nga stafi akademik me kohë të plotë. <i>Aneks 25 Rregullore për sigurimin e cilësisë e rishikuar</i> <i>Aneks 1. Statuti UAMD, Kreu VII "Sigurimi i Cilësisë".</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të	GVJ konstaton se Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional NjSBC në nivel Fakulteti si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë ushtrjnë kompetencat me funksione të plota në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë të Institucionit.

<p>cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion drejtuesit e programit dhe stafi akademik konfirmojnë së rishikimet e programit të studimit (nevoja të ndryshme për shtimin apo heqjen e lëndëve, përfshirjen e disiplinave të reja, ndryshimi i kategorizimit të disiplinave, apo ndryshime në ECTS dhe ngarkesën e orëve) janë realizuar konform kuadrit ligjor në fuqi me propozime të cilat vijnë nga departamenti dhe me miratim nga senati deri në masën 20 % të programit.</p> <p><i>Aneks 81. Pyetesor Student UAMD.</i> <i>Aneks 1. Statuti UAMD, Kreu VII "Sigurimi i Cilësisë".</i> <i>Aneks 25. Rregullore per Sigurimin e Cilesise e rishikuar.</i> <i>Vizita në institucion, takimi me drejtuesit e programit dhe stafin akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>UAMD i është nënshtruar në vitin 2016 procesit të Akreditimit Institucional dhe u vlerësua me një Akreditim për 4 vite akademike. Gjithashtu u vlerësua me 4 vite akademike në riakreditimin institucional i cili u realizua në vitin 2022.</p> <p>Ky program studimi, nuk i është nënshtruar akreditimeve të mëparshme.</p> <p><i>Aneks 139. Vendimi i Bordit të Akreditimit 2016.</i> <i>Aneks 141 Vendimi I Bordit te Akreditimit Insitucional 2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, pas të dhënave të marra nga RVB, diskutimet me pedagogët dhe studentët, konstaton se është shumë e rëndësishme që institucioni të përdorë tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Këto tregues janë të nevojshme për të pasqyruar gjendjen, arritjet dhe dobësitë e institucionit në mënyrë objektive. Ata ndihmojnë në vlerësimin e performancës së institucionit dhe në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Përdorimi i treguesve cilësorë lejon UAMD të identifikojë arritjet më të mira në programin e studimit.</p> <p>Nga analiza e raportit të vlerësimit të brendshëm institucional evidentohet se rezultatet e pyetësorëve me studentët janë një instrument që përdoren në funksion të përmirësimit të mësimdhënies. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe iu paraqiten të gjithë strukturave përkatëse duke nisur nga departamentet deri në Senatin Akademik.</p> <p>Përdorimi i treguesve cilësorë dhe promovimi i arritjeve më të mira në programin e studimit ndihmojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit në institucion. Kjo krijon një mjedis të stimulueshëm për studentët dhe kontribuon në përmirësimin e performancës së institucionit në përgjithësi.</p> <p><i>Aneks 81. Pyetesor Student UAMD.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit te studimit Bachelor Administrim Publik.</i></p>

Konkluzione	<p>GVJ konstaton se UAMD ka hartuar dhe ka zbatuar politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë, dhe keto politika janë zbatuar në nivelin e programit të studimit Bachelor në "Administrim Publik".</p> <p>GVJ udhëzon në vazhdimin e krijimit të praktikave efçente të garantimit të cilësisë së programit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VL3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se FSHPJ bashkëpunon me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë në përputhje me politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë me qëllim mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit.</p> <p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të lartë, Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore shkencore, në varësi të llojit të institucion. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukture të tij, sipas standardeve të cilësisë. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.</p> <p>Referuar Aneks 122 "Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë", Departamenti dhe Fakulteti kryejnë analizat vjetore dhe vlerësimin e brendshëm në përputhje me mekanizat rregullues të universitetit.</p> <p>Departamenti i Administrimit Publik si edhe ky program studimi nuk i janë nënshtruar një vlerësimi të mëparshëm të procesit të akreditimit. Megjithatë, analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor nga departamenti, Fakulteti dhe Universiteti shoqërohet me një plan të detajuar masash që adresojnë e synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive që mund të evidentohen.</p> <p>Programet e studimit në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike i janë nënshtruar riorganizimit në vitin akademik 2021-2022, kjo për arsye të pajisë studentët me njohuri e shprehje të avancuara dhe me kompetenca</p>

	<p>të gjëra që kërkohen për t'u punësuar në përputhje me nevojat e tregut të diversifikuar të punës, synon që të ofrojë një program studimi bazuar në kurrikul më bashkohore. Nga DKSC realizohet kontrolli i kurrikulave të propozuara, sipas akteve ligjore në fuqi mbi riorganizimin mbi 20% nën 20% si dhe për hapjet e programeve të reja.</p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit Bachelor Administrim Publik</i></p> <p><i>Aneks 25 Rregullore për sigurimin e cilësisë e rishikuar</i></p> <p><i>Aneks 1. Statuti UAMD, Kreu VII "Sigurimi i Cilësisë".</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, rezultojnë se vlerësimet që bëhen nga analiza vjetore dhe nga vlerësimet e brendshme të Departamentit dhe të Fakultetit, ku përfshihet dhe ky program studimi, analizojnë rezultatet pikërisht duke i krahasuar me atë çfarë ishte planifikuar.</p> <p>Raportet analitike dhe vlerësuese përmbajnë të dhëna për ecurinë e deritanishme, realizimin e pritshmërive në raport me objektivat, parashikimet për periudhat e ardhshme, si edhe adresimin e mangësive për përmirësime të mëtejshme të cilësisë. DKSC realizon për çdo vit akademik Raportin e Vlerësimit të Brendshëm i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik.</p> <p>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi që instrumenti i përdorur është i mjaftueshëm për të siguruar një vlerësim sa më holistik dhe të besueshëm në përputhje dhe me specifikën e fushës akademike të programit të studimit, si dhe të mundësohet përdorimi periodikisht i tyre.</p> <p><i>Aneks 95. Analiza dhe Raporti vjetor i DAP dhe programit të studimit 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimeve në institucion me pedagogët, Drejtuesin e DAP, studentët dhe DKSC se në kuadër të përmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe manualit për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike. Këto metoda të drejtpërdrejta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim të cilësisë së mësimdhënies, ku bën pjesë dhe ky program studimi; - Vlerësim të didaktikës, kurrikulës, leksioneve, syllabuseve, literaturave të përdorura; - Të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve; - Procesi i Tutorial/Mentorimit. <p>Ato analizohen dhe miratohen në departament në fillimin e vitit akademik.</p>

	<p><i>Aneks 23.1 Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</i> <i>Aneks 135 Vendim i Mentorimeve dhe grafiku.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë ka përfshirja e studentëve në këtë proces dhe i grupeve të tjera të interesit. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se përveç metodave të drejtëpërdrejta të kontrollit për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit, janë përdorur edhe metoda dhe instrumenta të tërthortë vlerësimi (sondazhe, intervista), kryesisht të fokusuar tek studentët, duke mundësuar kështu një vlerësim të plotë të realizimit të objektivave të programit dhe duke mos mundësuar mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit., GVJ sugjeron që e njëjta procedurë (intervista gjysëm të sturukturuara, fokus grupe apo dhe sondazhe), të ndiqet në vijueshmëri nga departamenti edhe për ata ish-studentë, bashkëpunëtorë, staf administrativ apo studentëve të këtij programi, si një mënyrë shumë efektive e vlerësimit të përgatitjes akademike që aktualisht ofrohet nga programi, por dhe vlerësimit të aftësive dhe kompetencave që ky program garanton dhe përputhshmërisë së tyre me treguesit real të avancimit akademik apo karrierës profesionale.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullorja e re UAMD.</i> <i>Aneks 81. Pyetesor Student UAMD.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimeve në institucion, konstaton se UAMD monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit. GVJ sugjeron që e njëjta procedurë (intervista gjysëm të sturukturuara, fokus grupe apo dhe sondazhe), të ndiqet në vijueshmëri nga departamenti edhe për ata ish-studentë, bashkëpunëtorë, staf administrativ apo studentëve të këtij programi, si një mënyrë shumë efektive e vlerësimit të përgatitjes akademike që aktualisht ofrohet nga programi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të</p>	<p>Për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit, institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar. Kjo përfshirje mund të realizohet nëpërmjet politikave dhe procedurave të brendshme të</p>

<p>jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>cilësisë. Aktorët e brendshëm përfshijnë stafin akademik, studentët dhe personelin administrativ të institucionit. GVJ konstaton se ata kanë rol aktiv në hartimin dhe vlerësimin e politikave dhe procedurave të cilësisë, ku marrin pjesë në diskutime dhe japin kontributet e tyre për përmirësimin e programit të studimit. Aktorët e jashtëm të përfshirë sipas bisedës me pedagogët dhe përgjegjësen e departamentit janë përfaqësues të organizatave profesionale dhe studentët Alumni, të diplomuarit. Përfshirja e tyre është zhvilluar duke i ftuar në panaiet e punës, përmes konsultimeve dhe takimeve.</p> <p>Përfshirja e studentëve shihet edhe në pjesëmarrjen e tyre tek GVB që ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm.</p> <p><i>Aneks 140 Vendimi i DAP per perzgjedhjen e Perfaqesuesit ne NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përmes përfshirjes së aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar, institucioni ka përfituar nga perspektivat e ndryshme dhe kontributet e tyre për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit. Kjo gjithashtu ka ndihmuar në krijimin e një kulture të cilësisë dhe në rritjen e përgjegjësisë së përbashkët në institucion.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e re UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Departamentit Administrim Publik.</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit te studimit Bachelor Administrim Publik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Për të vlerësuar dhe siguruar cilësinë e programit të studimit, është e rëndësishme të kemi njësinë bazë dhe kryesore që është përgjegjëse për programin e studimit, e cila përfshin anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentë të programit të studimit Bachelor Administrim Publik. GVJ konstaton se kjo përfshirje e të gjithë palëve të interesuara realizohet. Kjo është e rëndësishme për të siguruar një proces të drejtë dhe të përshtatshëm të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Aneks 3. Rregullore e re UAMD.</i></p> <p><i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i></p> <p><i>Aneks 9. Rregullore e Departamentit Administrim Publik.</i></p> <p><i>Aneks 31. Rregullore e programit te studimit Bachelor Administrim Publik.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit është shumë i rëndësishëm për të siguruar integritetin akademik dhe për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazi ndaj personelit dhe studentëve. GVJ konstaton se kjo përfshirje është e drejtë, transparente dhe e bazuar në kriteret e përcaktuara paraprakisht. Aktorët e brendshëm, si profesorët, stafi administrativ dhe studentët, kanë mundësi të kontribuojnë në proceset e vlerësimit, duke dhënë mendimet dhe vlerësimet e tyre në mënyrë të lirë dhe të ndershme. Kjo ndihmon në rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së të gjithë palëve të përfshira në procesin e vlerësimit. Gjithashtu, është e rëndësishme të sigurohet se këto procese janë të hapura për të gjithë dhe nuk</p>

	<p>favorizojnë asnjë grup ose individ në mënyrë të padrejtë. UAMD ka miratuar edhe rregulloren për studentët me aftësi të kufizuara, në këtë mënyrë, integriteti akademik dhe drejtësia do të ruhen në të gjitha fazat. <i>Aneks 9. Rregullore e Departamentit Administrim Publik.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit Bachelor Administrim Publik.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga takimet me pedagogët dhe drejtuesit e njësive u shprehën se pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike është përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm. Këta individë kanë lidhje me programin e studimit dhe kanë ekspertizë të veçantë në fushën e lidhur me cilësinë e programit. Vlerësimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit është marrë gjatë organizimit të takimeve me institucione të ndryshme publike në nivel qendror dhe lokal, gjatë organizimit të Panairit të Punës dhe të ftuarve në Konferenca të organizuara në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike dhe UAMD. Përvoja dhe mendimet e tyre të vyera janë të dobishme për të vlerësuar cilësinë e programit dhe për të identifikuar mënyra për përmirësimin e saj. Kjo përfshirje e ekspertëve të jashtëm sjell një perspektivë të re dhe ndihmon në rritjen e cilësisë së programit. <i>Aneks 3. Rregullore e re UAMD.</i> <i>Aneks 8. Rregullore e FSHPJ.</i> <i>Aneks 9. Rregullore e Departamentit Administrim Publik.</i> <i>Aneks 31. Rregullore e programit të studimit Bachelor Administrim Publik.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Përfaqësues të studentëve përfshihen në çdo organ kolegjal duke filluar nga Senati Akademik e deri tek GVB për hartimin e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm. Përfaqësimi i studentëve realizohet edhe në Bordin e Administrimit, NjBSC të fakultetit dhe në formë këshillimore, përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit kur trajtohen çështje të lidhura me ta. GVJ konstaton se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, pedagogët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e departamenteve dhe FSHPJ, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në faqen e internetit të institucionit gjenden të publikuara informacione të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e NJSBC.</p> <p>Nga takimet e drejtëpërdrejta me studentët, GVJ konstatoi se për grupet e reja të studentëve realizohet java informuese, ku studentët informohen nga lektorët e departamentit në lidhje me funksionimin dhe organizimin e çdo programi studimi.</p> <p>Pranë UAMD prej vitesh realizohet raportimi vjetor nga ana e rektoratit lidhur me realizimin e objektivave të parashtruara. Në të njëjtin format edhe pranë fakulteteve dhe departamenteve realizohet në mënyrë periodike informim dhe mendimarrje nga strukturat e ndryshme me kolegët lektorë, stafin administrative dhe studentët.</p> <p>Nëpërmjet web-it të UAMD, komunikimeve më email, takimeve informuese dhe publikimet në rrjetet sociale, studentët informohen periodikisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p><i>Aneks 130. Raport Vjetor FSHPJ v.a.2019-2020.</i> <i>Aneks 131. Raporti Vjetor FSHPJ v.a.2020-2021.</i> <i>Aneks 132. Raporti Vjetor FSHPJ.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton se UAMD në mënyrë periodike realizon takime dhe aktivitete me qëllim njohjen me rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit. Këto takime kanë formën e diskutimeve dhe bashkëbisedimeve mbi materialet finale të raporteve të vetëvlerësimit sic edhe është parashikuar në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Programi në fjalë është në procesin e akreditimit për herë të parë. Nga verifikimet e kryera rezulton të jenë bërë publike për stafin dhe studentët rezultatet e pyetësorëve, sigurisht duke mbajtur në konsideratë mbrojtjen e të dhënave personale. Aktorët e interesuar kanë mundësi të njihen me këto raporte.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton se është përgatitur programi i transparencës i cili konsiston në përcaktimin e rregullave bazë të organizimit dhe të funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Programi i transparencës në UAMD i shërben rritjes së transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale të universitetit sipas objektit dhe qëllimit të këtij ligji duke pasur parasysh interesin më të mirë të publikut. Publikimi i informacionit përmes këtij</p>

	<p>programi ka si qëllim t'i shërbejë transparencës të organizimit dhe funksionimit si dhe të misionit dhe veprimtarisë së UAMD-së dhe realizohet përmes publikimit të detajuar të këtij informacioni në faqen zyrtare të internetit, si dhe në mjediset e pritjes së publikut.</p> <p><i>Aneks 30. Programi i Transparencës së UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Administrimit Publik si edhe ky program studimi nuk i janë nënshtruar një vlerësimi të mëparshëm të procesit të akreditimit. Megjithatë, analiza vjetore e procesit mësimor dhe kërkimor nga departamenti, Fakulteti dhe Universiteti shoqërohet me një plan të detajuar masash që adresojnë e synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive që mund të evidentohen.</p> <p>Vlerësimet dhe analizat e realizuara identifikojnë nevojat për përmirësime të metejshme. Stafi i Fakultetit të Shkencave Politike Juridike angazhohen dhe marrin masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme. Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> <p><i>Aneks 130. Raport Vjetor FSHPJ v.a.2019-2020.</i> <i>Aneks 131. Raporti Vjetor FSHPJ v.a.2020-2021.</i> <i>Aneks 132. Raporti Vjetor FSHPJ v.a.2021-2022.</i> <i>Aneks 133. Raport Vjetor UAMD 2020-2021.</i> <i>Aneks 134. Final Raport Vjetor UAMD 2021-2022.</i> <i>Aneks 95. Analiza dhe Raporti vjetor i DAP dhe programit të studimit 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>NJSBC analizon në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe ato të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes bashëpunimit me Departamentet, Fakultetet dhe Njësitë ndihmës akademike në nivel universiteti. Produkt i kësaj analize periodike janë raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe raporti vjetor i IAL që dorëzohet në MASR. Raportet diskutohen në strukturat vendimarrëse përpara se të publikohen dhe miratohen prej tyre.</p> <p><i>GVJ mendon që krahas këtyre raporteve, NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar lidhur me programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se NJSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe të fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e të vlerësimit të cilësisë. Ndër veprimtaritë kryesore që institucioni ka ndërmarë në lidhje me ndërgjegjësimin dhe informimin e studentëve dhe personelit kanë qenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimi i stafit për proceset e vlerësimit; - Informimi i studentëve mbi rëndësinë e vlerësimit të kurrikulës/pedagogut për përmirësimin e programit të studimit;

	<p>- Përfshirja e studentëve në plotësimin e pyetësorëve për vlerësimin e performancës. Departamenti i Administrimit Publik gjithashtu në përputhje me kërkesat për cilësisë afatgjatë organizon veprimtari informuese me studentët e secilit cikël të studimeve. Faqja Zyrtare UAMD www.uamd.edu.al.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. Konkretisht, kjo është realizuar nëpërmjet publikimit të Rregullores së UAMD, Rregullores së Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. GVJ mendon që krahas këtyre raporteve, NJSBC duhet të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar lidhur me programin e studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Administrim Publik”, ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Pika të forta dhe afirmime:

1. Personeli akademik i kualifikuar dhe me profil në përputhje me objektivat e programit studimor e bën këtë program mjaft tërheqës për studentin. Gjithashtu, angazhimi i tyre në mobilitete me universitete partnere ndërkombëtare rrit cilësinë e mësimdhënies.
2. Kushtet infrastrukturore në Kampusin e UAMD mundësojnë zhvillimin e një procesi mësimor bashkëkohor dhe frytdhënës.
3. Sistemi i brendshëm i menaxhimit institucional është një praktikë shumë e mirë mbështetëse e procesit të studimit dhe lehtëson procesin administrativ, informues dhe monitorues të aktiviteteve akademike e administrative për programin e studimit.
4. Organizimi i konferencave shkencore dhe workshopeve me partnerë ndërkombëtarë.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e lëndës së Praktikës Profesionale në kurrikulën e programit të studimit. **(Standardi II.1, kriteri 4; Standardi II.4, kriteri 3; Standardi IV.1, kriteri 7 dhe 8)**
2. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe, të përshtatshme për nevojat e programit të studimit, në syllabuset e disa prej lëndëve të programit si dhe në kopje fizike në bibliotekën e Institucionit. **(Standardi IV.3, kriteri 1, 2, 8)**
3. Procedurat dhe njësitë e posaçme të ngritura nga institucioni për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme, nuk janë lehtësisht të arritshme nga studentët dhe prezente e funksionale në institucion. **(Standardi V.6, kriteri 3 dhe 4)**

Rekomandime:

1. Institucioni, të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit Praktikën profesionale. **(Standardi II.1, kriteri 4; Standardi II.4, kriteri 3; Standardi IV.1, kriteri 7 dhe 8)**
2. Institucioni, të shohë me prioritet shtimin e literaturës në gjuhën shqipe në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi dhe numrin e titujve specifik të fushës së administrimit publik në bibliotekën e universitetit. **(Standardi IV.3, kriteri 1, 2, 8)**
3. Institucioni, të ndër marrë masa e aktivitete mbi promovimin dhe rolin e njësitë të posaçme të ngritura për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, në mënyrë që ato të jenë prezente e aktive në institucion dhe lehtësisht të aksesueshme nga studentët. **(Standardi V.6, kriteri 3 dhe 4)**
4. NJSBC, të hartojë një raport vjetor të posaçëm për të gjithë aktivitetin e saj, instrumentat që ka përdorur për vlerësimin e brendshëm dhe të identifikojë praktika të mira dhe/ose probleme që duhen adresuar lidhur me programin e studimit. **(Standardi VI.5, kriteri 4)**

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Public Administration", provided by "Aleksandër Moisiu" University, Durrës

Strengths and affirmations:

1. Qualified academic staff with profiles aligned with the objectives of the study program make this program quite attractive to students. Additionally, their engagement in mobilities with international partner universities enhances the quality of teaching.
2. The infrastructure conditions at the UAMD Campus enable the development of a contemporary and fruitful teaching process.
3. The internal institutional management system is a very supportive best practice of the study process, facilitating administrative, informative, and monitoring processes of academic and administrative activities for the study program.
4. Organization of scientific conferences and workshops with international partners.

Weaknesses:

1. Lack of the Professional Practice course in the curriculum of the study program. **(Standard II.1, Criterion 4; Standard II.4, Criterion 3; Standard IV.1, Criterion 7 and 8)**
2. Absence of literature in Albanian language, suitable for the needs of the study program, in the syllabi of some subjects of the program as well as in physical copies in the Institution's library. **(Standard IV.3, Criterion 1, 2, 8)**
3. The procedures and special units established by the institution for the reception, orientation, counseling of students, management of complaints and issues, which exercise activity permanently, are not easily accessible to students and are not present and functional in the institution. **(Standard V.6, Criterion 3 and 4)**

Recommendations:

1. The institution should include Professional Practice in the study program curriculum. **(Standard II.1, Criterion 4; Standard II.4, Criterion 3; Standard IV.1, Criterion 7 and 8)**
2. The institution should prioritize the addition of literature in Albanian language in the syllabi of the subjects of this study program and the number of specific titles in the field of public administration in the university library. **(Standard IV.3, Criterion 1, 2, 8)**
3. The institution should take measures and activities to promote and enhance the role of special units established for the reception, orientation, counseling of students, management of complaints and issues, to ensure their active presence in the institution and easy accessibility for students. **(Standard V.6, Criterion 3 and 4)**
4. The IQAU should prepare a special annual report on all its activities, the instruments used for internal assessment, and identify best practices and/or issues to be addressed regarding the study program. **(Standard VI.5, Criterion 4)**



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X